Në datën dhe orën e përcaktuar, Autoriteti/Enti Kontraktor hap propozimet ekonomike. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar do të lejohen të ndjekin hapjen e propozimeve. Zarfi ku shkruhet “Propozimi Ekonomik” për secilin propozim që nuk është refuzuar më parë, do të hapet dhe informacioni i mëposhtëm do të shpallet e regjistrohet: emri i Ofertuesit, rezultati i vlerësimit të propozimit teknik, Çmimi i propozuar, siç shprehet në propozimin ekonomik.

## 21. Vlerësimi i propozimeve ekonomike

1. Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton nëse propozimet ekonomike janë të plota, korrigjon ndonjë gabim arithmetike dhe për qëllime krahasimi e vlerësimi, i konverton të gjitha çmimet e propozimit në një monedhë të vetme. Autoriteti/Enti Kontraktor rendit dhe cakton një rezultat për çdo propozim ekonomik.

2. **Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:**

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik
Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar
Ç – Çmimi Ofertues i Radhës *(duke filluar nga çmimi më i ulët)*

**Pe = 100 x Çu / Ç**
(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

**Vlerësimi përfundimtar**

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

**Pesha për Propozimin Teknik: X = (pikët e propozimit teknik x 0.8)**

**Pesha për Propozimin Ekonomik: Y = (pikët e propozimit ekonomik x 0.2)**

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

**Oferta më e mirë = X + Y**

Operatori ekonomik që ka marrë më shumë pikë gjatë mbledhjes së pikëve teknike dhe ekonomike do të ftohet për negociata dhe lidhjen e kontratës.

**22. Korrigjimi i gabimeve arithmetike**

Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon propozimet ekonomike të paraqitura nëse kanë gabime arithmetike. Nëse propozimet rezultojnë me gabime arithmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

**(a)** Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.

**(b)** Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të.

**(c)** Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korrigjohet.

**(d)** Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por korrigjimi

nuk pranohet nga ofertuesi.

**23. Krahasimi i propozimeve**

Autoriteti/Enti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fillon bisedimet me fituesin për të sqaruar dhe për të përmirësuar kushtet e kontratës, metodologjinë, përbërjen e stafit dhe kushtet e veçanta. Bisedimet nuk duhet t’i ndryshojnë në mënyrë thelbësore kushtet fillestare të kontratës ose propozimin e përzgjedhur.

Oferta ekonomike nuk duhet të ndryshohet në asnjë rast.

**24. Konvertimi në valutë të vetme**

1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontratës.

## G. DHËNIA E KONTRATËS

**25.Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Propozimit, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Propozimi i tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**26. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve, Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen Kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

a) garanci bankare

b) garanci nga shoqëri sigurimi.

## H. ANKESAT

**27. Procedura e ankesës**

1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

### I. ANULIMI I PROCEDURËS

**28. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Kërkesë për pjesëmarrje
Shtojca 2: Ftesa për Propozim
Shtojca 3: Formulari i Deklarimit të Propozimit
Shtojca 4: Formulari i Propozimit Ekonomik
Shtojca 5: Formulari i Sigurimit të Ofertës
Shtojca 6: Lista e Informacionit Konfidencial
Shtojca 7: Deklaratë për disponueshmërinë e stafit të konsulentit
Shtojca 8: Formulari i Specifikimeve Teknike
Shtojca 9: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit
Shtojca 10: Formulari i Termave të Referencës
Shtojca 11: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes se Ofertuesve
Shtojca 12: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të skualifikimit
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)
Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)
Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraprak)
Shtojca 17: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

**Shtojca 1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

**KËRKESË PËR PJESËMARRJE**

______________________________
*(Emri i operatorit ekonomik dhe NIPT-i)*

*[Data______]*

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*
Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Unë (Ne), të nënshkruarit, paraqesim kërkesën tonë për pjesëmarrje për këtë procedurë:

**Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Datë**

**Shtojca 2**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti/enti kontraktor*]

**FTESË PËR PROPOZIM**

*(Vetëm për kandidatët e përzgjedhur pas shqyrtimit të kërkesave për pjesëmarrje)*

[Data]
Për : *[Emri dhe adresa e ofertuesit të përzgjedhur]*
___________________________________

**Procedura e Prokurimit**: ________________________________

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se *[emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur]*, pas vlerësimit të dokumentave të paraqitura në fazën e pare, jeni kualifikuar për në fazën e e paraqitjes së propozimeve.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë ________________________________(*emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor)*

propozimin tuaj, duke marrë parasysh se:

**Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e propozimit është :**

**Data, ora dhe adresa**

Data: □□/□□/□□□□*(d/m/v)* **ora** □□:_□□
Adresa: _______________________________________

**Kur propozimi kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë propozimin në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al**

**Informacioni mbi propozimet e paraqitura me mjete elektronike, i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar propozime, në bazë të kërkesës së tyre.**

**Gjuha(-ët) për hartimin e propozimeve janë:**

Shqip ☐ Anglisht ☐

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit :**

Autoriteti/Enti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Ofertuesi që arrin rezultatin më të lartë të kombinuar teknik e financiar do të ftohet për negociata për lidhjen e kontratës.

Jemi në pritje të propozimit tuaj.

**Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor**

**Shtojca 3**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

**FORMULARI I DEKLARIMIT TË PROPOZIMIT**

*[Data______]*

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*
Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/ Nr. Referencës në faqen e APP-së*

Emri i operatorit ekonomik dhe NIPT-i

Unë (Ne), të nënshkruarit, deklarojmë se:

**(a)** Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

**(b)** Ne **[*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*)**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në

përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*]**.

**(c)** Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me grafikun e kërkuar të kryerjes së shërbimit.

**(d)** Ne nuk marrim pjesë si kandidatë në më shumë se një propozim në këtë procedurë prokurimi.

**(d)** Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike dhe termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

**e)** Çmimi Total i propozimit tonë është shprehur në propozimin ekonomik.

**Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Datë**

**Shtojca 4**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

**FORMULARI I PROPOZIMIT EKONOMIK**

**Tarifat sipas Kategorisë së Punës :** **(**Nëntotali i detajuar)

**Pagesat Ditore:** **(**Nëntotali i detajuar)

**Kostot e Drejtpërdrejta:** **(**Nëntotali i detajuar)

**Shpenzimet e Rimbursueshme:** **(**Nëntotali i detajuar)

**TOTALI**

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 5**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*
[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*
Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*
Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 7**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË**
**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit[2]**

[2] Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga seicili prej anëtarëve të stafit të konsulentit dhe do të jetë pjesë e dokumentave të ofertës së konsulentit.

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti/Enti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Në bazë të parashikimeve të neneve 41 dhe 54 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", Unë i nënshkruari _____________________, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit "............................................." për procedurën e prokurimit me objekt______________ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj*** se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin "…………………………………….." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti/Enti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt ………………………………………………………., është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, ***me asnjë*** nga anëtarët e stafit të autoritetit/entit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës ________________

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

Vula

**Shtojca 8**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 9**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

## FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

**Shërbimi që kërkohet:**

- **Loti i I: (**Studim Projektim per objektin,’’**Ndërtim Qendre Rekreative dhe Rikualifikim Urban i Parkut të Rezervuarit Thumanë, Krujë”** .
- **Loti i II: (**Studim Projektim per objektin,**“ Sistemim-asfaltim i rrugës Borizanë-Superstrada Fushë Krujë Milot, Nj.A.Thumanë, Krujë” .**

**Afatet e ekzekutimit:**

- **Loti i I: (**Studim Projektim per objektin,’’**Ndërtim Qendre Rekreative dhe Rikualifikim Urban i Parkut të Rezervuarit Thumanë, Krujë”** , me afat ekzekutimi 60(gjashtedhjete) dite nga data e nenshkrimit te kontrates.
- **Loti i II: (**Studim Projektim per objektin,**“ Sistemim-asfaltim i rrugës Borizanë-Superstrada Fushë Krujë Milot, Nj.A.Thumanë, Krujë” ,** me afat ekzekutimi 60(gjashtedhjete) dite nga data e nenshkrimit te kontrates.

**Shtojca 10**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

# TERMA REFERENCE
# **SHËRBIM KONSULENCE**

PËR HARTIMIN E
PROJEKTIT TË ZBATIMIT PËR OBJEKTIN:
**“NDËRTIM QENDRE REKREATIVE DHE RIKUALIFIKIM URBAN I PARKUT TË REZERVUARIT THUMANË, KRUJË”**

**LËNDA**


1. **PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM**
   - 1.1. TË DHËNAT GJEOGRAFIKE TË ZONËS
   - 1.2. KUFIJTË DHE ZONIMI I PARKUT TË REZERVUARIT
   - 1.3. INFORMACION MBI ZONËN NË STUDIM
     - a) Rezervuari i Thumanës

2. **QËLLIMI, OBJEKTIVAT DHE NDIKIMI I PRITSHËM**
   - 2.1. QËLLIMI
   - 2.2. OBJEKTIVAT
     - a) Projekti i Zbatimit
   - 2.3. NDIKIMI I PRITSHËM

3. **PËRSHKRIM I PUNËS**
   - 3.1. METODOLOGJIA
   - 3.2. SHËRBIMET E KËRKUARA DHE DOKUMENTAT PËR DORËZIM
     - a) Projekti i Zbatimit
   - 3.3. STANDARDET, KËRKESAT ARKITEKTONIKE E KONSTRUKTIVE TË OBJEKTIT
   - 3.4. FAZIMI I PUNËS
     - 3.4.1. Analiza e detyrës së projektimit, rilevimi;
     - 3.4.2. Projekt – idea paraprake;
     - 3.4.3. Projekt – idea perfundimtare;
     - 3.4.4. Projekti i detajuar i zbatimit për ndërhyrjen;
     - 3.4.5. Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis.

4. **REALIZIMI I PROJEKTIT**
   - 4.1. PROFILET E EKSPERTËVE, KUSHTET DHE DETYRIMET
   - 4.2. PLANIFIKIMI DHE DORËZIMET
     - 4.2.1 Periudha e fillimit
     - 4.2.2 Periudha e përfundimit e parashikuar ose kohëzgjatja
     - 4.2.3 Planifikimi - përfshirë periudhën e njoftimit për vendosjen e stafit
   - 4.3. RAPORTIMI
   - 4.4. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

4.4.1. Përcaktimi i treguesve
4.4.2. Angazhimi gjatë implementimit
4.4.3. Lehtësirat për Konsulentin dhe Aksesi në Informacion
4.4.4. Takimet teknike dhe mes palëve të interesuara

5. REFERENCA |SHTOJCA

# 1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

## 1.1. TË DHËNAT GJEOGRAFIKE TË ZONËS

Thumana shtrihet në pjesën Veriore të bashkisë Krujë dhe kufizohet;

- në Lindje – fshati Brret, territori i Njësisë Vendore Krujë – Krujë;
- në Jug - nga Njësia Administrative Fushë Krujë;
- në Veri - nga bashkia Kurbin (Njësia Administrative Mamurras);
- në Perëndim - nga kufiri administrativ i bashkisë Durrës (Njësia Administrative Ishëm)

Rezervuari i Thumanës ndodhet në verilindje të qendrës së banimit Thumanë, në lindje të zonës së re për zhvillim (SITE të Rindërtimit Thumanë). Parku ndodhet kryesisht në perimetrin e rezervuarit Thumanë, si dhe një pjesë ndërmjet sitit të Rindërtimit dhe digës së liqenit.

Thumana ka një sipërfaqe urbane rreth 5 km2 dhe sipërfaqe administrative 58 km2 , e cila përbën 1.48 % të sipërfaqës së përgjithshme të rrethit Krujë prej 339 km2, ku banojnë rreth 14300 banorë, të organizuar në dhjetë fshatra (Thumanë, Derven, Borizanë, Dukagjin i Ri, Gramëz, Miliskaj, Kodër Thumanë, Bushnesh, Derven Kodër, Sukth Vendas) dhe një qendër urbane (qyteza Thumanë). Nga këto 66.6% jetojnë në fshatrat përreth ndërsa 33.4% në qytezën Thumanë. Ndodhet në koordinatat gjeografike; 41°32'53'' Veri dhe 19°40'43'' Lindja, në Grade, Minuta, Sekonda.
Referuar studimeve të bëra nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Thumana dhe zona perëndimore përreth tij bëjnë pjesë në zonën Kodrinore e Fushore.

**Harta shoqëruese Gjeologo-Inxhinierike**.



## 1.2. KUFIJTË DHE ZONIMI I PARKUT TË LIQENIT THUMANË




Kufijtë e këtij Parku janë si më poshtë vijon:

**Veri:** nga rruga e Fabrikës së Çimentos Titan;
**Lindje:** përgjatë kodrave të bregut të liqenit dhe kufirit me territorin e varrezave të reja Thumanë;
**Jug:** përgjatë bregut të liqenit mbi fshatin kodër Thumanë, fundi i SITE të Rindërtimit Thumanë;
**Përëndim:** Lagja Thumanë, nga SITE i Rindërtimit Thumanë.

Parku i Liqenit të Thumanës, ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 32 ha, ku pjesën kryesore të territorit e zënë sipërfaqet me bimësi të ulët si shkurre, ferra, barishte e kullota. Sipërfaqja e përdorimit të territorit të Parkut të liqenit Thumanë jepet në tabelën e mëposhtme:




Tabela 1. Të dhëna mbi përdorimin e territorit
ZONA THU-003, SIP.27.8ha
ZONA THU-005, SIP.128.5 ha(zona përreth liqenit reteh 40ha)

Parku i liqenit Thumanë përfshin liqenin dhe zonën përreth, si dhe territorin mbi SITE të rindërtimit, si zona të rëndësishme për konservimin e biodiversitetit, por gjithashtu edhe për potencialin e madh për zhvillim e ekoturizmit. Në këtë aspekt, Parku përfshin gjithashtu disa zona që nuk kanë rëndësi nga pikëpamja e biodiversitetit por janë të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm ekonomik dhe social të Njësisë Administrative. Kjo do t’u japë këtyre zonave një vlerë shtesë në të ardhmen, si dhe do të ofrojë bazën për kritere të shëndosha menaxhimi mjedisor brenda këtyre zonave në të ardhmen.

## 1.3. INFORMACION MBI ZONËN NË STUDIM




Foto Google . Liqeni Thumanë

a) **Rezervuari i Thumanës**

Rezervuari i Thumanës u ndërtua rreth viteve 60’ nga ndërmarrja e bonifikimit të asaj kohe. Nga mungesa e vepres se marrjes ne lumin Drojë që furnizon rezervuarin e Thumanës, ky rezervuar aktualisht ka një sasi të vogël uji dhe kapcitet minimal. Gjithashtu ky rezervuar ka edhe digën në anën perendimore dhe jugperëndimore të saj, pranë sitit të Rindërtimit, me një gjatësi dige prej rreth 400ml (në bjefin e poshtëm rreth 380m, ndërsa në kurorë rreth 425ml). Lartësia e digës (argjinaturës) është rreth 15m.



Foto.  Liqeni i Thumanës



Foto.  Liqeni i Thumanës

Kërcënimet ndaj biodiversitetit janë të pritshme.
Këto kërcënime janë:

- tendenca për zënie të fondit pyjor,
- ndryshim destinacioni të tokës (në sipërfaqe ndërtimi, karrierë etj.),
- zjarret në pyje dhe tokat bujqësore,
- kërkesa për prodhime drurore (dru zjarri, lëndë ndërtimi),
- grumbullimi i bimëve mjeksore dhe prodhimeve të tjera jo drurore,
- zhvillimi i zonës në përgjithësi, kërkon zona/sipërfaqe të reja

Liqeni i Thumanës ka një sipërfaqe të konsiderueshme ujore, kullota e me bimësi, si edhe ky liqen ka shtuar habitatet ujore në liqen dhe zonën përreth. Prezenca e zonës së banimit shumë pranë liqenit ka sjellë edhe një kërcënim serioz për boidiversitetin e zonës.
Kjo zonë ofron shumë mundësi për turizëm, ku mbizotërojnë kryesisht peizazhet panoramike. Në Thumanë ka edhe bare e restorante me gatimet e zonës dhe është një mënyrë e mirë për tu treguar mysafirëve se çfarë ofron ajo, por mungesa e infrastrukturës dhe zaptimi i territorit e ka bërë të pamundur shfrytëzimin maksimal të territorit.
Kulinaria është e pasur. Gatimet tradicionale të zonës Thumanë, janë me prodhime peshku, nga liqeni i Thumanës por edhe nga bregdeti dhe lugina e Patokut, bukë e bërë vetë me misër, byrek, tollum, kek e ëmbëlsira të tjera.



Foto. Liqeni i Thumanës (Fragment nga argjinatura e brendshme)

b) **Zonat përreth liqenit të Thumanës**

Përreth liqenit Thumanë shtrihet një territor perimetral kryesisht me bimësi të ulël (shkurre, barishte, ferra dhe bar), e cila është e pasistermuar, e cila pengon edhe qarkullimit përreth liqenit, çka e bën të pamundur atraksionin turistik në këtë zonë.
Në anën perendimore të liqenit ndodhet diga e saj, me një gjatësi prej...m, e cila ndan edhe zonën e SITE të rindërtimit me liqenin. Aktualisht ky territor perimetral është i pasistemuar. Në këtë projekt kërkoet sistemimi i gjithë perimetrit të liqenit me rrugë për këmbësorët, korsi bicikletash, pistë vrapimi, qendra çlodhëse si edhe rrugë e asfaltuar (lidhja e SITE të Rindërtimit me parkun). I gjithë territori përreth saj kërkohet të sistemohet me stola, kosha mbeturinash, pemë dekorative, vendqendrime me konstruksion metalik, ndriçim e ambjente të gjelbëruara, për ti dhënë një atraksion turistik gjithë territorit të liqenit e përreth saj.



Foto. Liqeni i Thumanës(Fragment nga Parku i Liqenit)



Foto.  Liqeni i Thumanës (Fragment nga argjinatura)



Foto.  Liqeni i Thumanës (Fragment nga rruga e Liqenit)



Foto.  Liqeni i Thumanës(Fragment nga Parku i Liqenit)



Foto.  Liqeni i Thumanës (Fragment nga Parku i Liqenit)



Foto. Liqeni i Thumanës (Fragment nga Parkui Liqenit)

Liqeni ka një gjatësi perimetrale prej 2.5 kilometra, me thellësi prej 15 metra dhe gjerësi 350 metra. Në dy anët e liqenit ngrihen kodra të vogla, ndësta në pjesën jug-perendimore shtrihet fusha e Thumanës. Ndërsa peizazhi përreth tij rrethohet me gjelbërim.
Në liqenin e Thumanës rriten disa lloje të peshqve: krapi, mustaku sardelja. Gjithashtu në liqen ka edhe shpend të ndryshëm.

## 2. QËLLIMI, OBJEKTIVAT DHE NDIKIMI I PRITSHËM

### 2.1. QËLLIMI

Ky dokument shërben në hartimin e projektit të zbatimit për obkjektin "Ndërtim Qendre Rekreative dhe Rikualifikim Urban i Parkut të rezervuarit të Thumanës".
Qëllimi kryesor i projektit është: Kthim në atraksion turistik e rikualifikimi urban i zonës, mbrojtja e vlerave biologjike, kulturore, sociale, ekonomike, të peizazhit të zonës, si dhe pëmbushjen e disa nën-qëllimeve:

- Reduktim i kërcënimeve ndaj diversitetit biologjik dhe të peizazhit;
- Rritja e diversitetit biologjik dhe të peizazhit;
- Të sigurohet përfshirja e plotë e publikut në mbrojtjen e diversitetit biologjik dhe të peizazhit;
- Të garantojë një instrument për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës, përmes mbrojtjes së natyrës dhe vlerave kulturore;

- Ndërhyrje të caktuara për rikualifikimin dhe rikompozimin e parkut edhe në pjesën infrastrukturore të cilat do të përmirësojnë akoma edhe më shumë pjesën atraktive të saj.

## 2.2. OBJEKTIVAT

Konsulenti do të ofrojë dhe udhëheqë punën për hartimin e projektit të zbatimit për objektin "Ndërtim Qendre Rekreative dhe Rikualifikim Urban i Parkut të rezervuarit të Thumanës". Ky propozim duhet:

- të jetë konsistent dhe i integruar me programin qeveritar të menaxhimit të zonës së mbrojtur;
- të jetë i strukturuar dhe shkruar në një mënyrë që personeli i zonës së mbrojtur të jetë në gjendje të marrë planin dhe të zbatojë me përpjekje minimale dhe kuptim maksimal;
- të jetë i detajuar dhe i strukturuar kur rekomandon të gjitha aktivitetet e mundshme eko-turistike të shoqëruara me një plan fizibiliteti që përfshin menaxhim dhe financim.

### a. Objetivat kryesorë të Projektit të zbatimit

- Rikualifikimi dhe rikompozimi i Parkut të rezervuarit Thumanë.
- Ndërhyrje specifike në infrastrukturën përgjatë rezervuarit dhe tek segmentet rrugore ekzistuese në hyrje të qytezës (SITE i Rindërtimit);
- Krijimi i shtigjeve natyrore;
- Krijimi i vendeve të pushimit përgjatë liqenit të Thumanës.
- Ndërtimi i vend-qëndrimeve për vizitoret dhe strukturave atraktive të harmonizuara me peizazhin dhe kontekstin natyror e historik(konstruksione metalike me mbulesë);
- Pika panoramike (buzë liqenit dhe në pjesën e sipërme të fshatit Thumanë);
- Ndërtimi i strukturave akomoduese miqësore me mjedisin;
- Krijimi i hapësirave të përshtatshme për kamping;

## 2.3. NDIKIMI I PRITSHËM

Bashkia Krujë ka nisur punën për koordinimin e procesit për hartimin e projektit të zbatimit për Parkun e Liqenit të Thumanës dhe zonën përreth tij.
Nëpërmjet këtij projekti synohet të realizohet ruajtja në gjendjen natyrore të peizazhit, sistemet ekologjike dhe karakteristikat natyrore të zonës. Pritet që plani dhe projekti i zbatimit të shpien drejt zhvillimit të qëndrueshëm të territorit ku bënë pjesë zona në studim, të kontrollit të zhvillimit, rritjes së mirëqënies së popullsisë vendase, punësimit, jetësës më të mirë dhe mbrojtjes së aseteve natyrore e mjedisit. Parku është një zonë me vlera të larta të biodiversiteti dhe peizazhit, një vend i njohur për bukuritë e veçanta natyrore, që do të vazhdojë të shfaqë ato cilësi që e veçojnë atë: një zonë me komunitetet lokal të gjallë dhe aktiv, duke siguruar një përvojë të veçantë për vizitorët e tij të shumtë.

## 3. METODOLOGJIA E PUNËS, SHËRBIMET E KËRKUARA DHE DOKUMENTAT PËR DORËZIM

### 3.1. METODOLOGJIA

Konsulenti thirret, nëpërmjet këtij projekti, për të asistuar në diskutimet me bashkinë Krujë, me qëllim kthimin e kësaj zone në atraksion turistik.

Konsulenti do të punojë ngushtësisht me stafin e bashkisë Krujë përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit. Në mbështetje, është ngritur Grup pune për të koordinuar procesin për hartimin e projektit të zbatimit, i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin, vlerësimin e procesit, koordinimin dhe bashkërendimin e tij, sikurse edhe të produkteve që do të dalin prej tij dhe do të mbështesë të gjitha palët e përfshira në proces për t'u njohur dhe familjarizuar me detyrimet ligjore që rrjedhin nga detyra.

Periudha për draftimin e planit dhe ndjekjes së hartimit të projektit do të shtrihet në **2 muaj** dhe do të ndahet në faza për efekt të organizimit të procesit të punës, sipas përcaktimeve VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim".

### 3.2. SHËRBIMET E KËRKUARA DHE DOKUMENTAT PËR DORËZIM

**3.2.1.** Hartimin e projektit të zbatimit për objektin: Ndërtim Qendre Rekreative dhe Rikualifikim Urban i Parkut të Rezervuarit e Thumanës".

#### a) Projekti i zbatimit

- Analiza e detyrës së projektimit, rilevimi, mbledhja e dokumenteve;
- Projekt – idea paraprake;
- Projekt – idea perfundimtare;
- Projekti i detajuar i zbatimit për ndërhyrjen;

### 3.3. STANDARDET, KËRKESAT ARKITEKTONIKE E KONSTRUKTIVE TË OBJEKTIT

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Në hartimin e projektit të mbahen parasysh normat e miratuara për personat me aftësi të veçanta. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori. Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Gjatë gjithë fazave të projektimit, grupi i projektimit do të analizojë e të japë të dhëna të hollësishme për ecurinë.

**<u>Kërkesa arkitektonike e konstruktive të objektit</u>**

Kontraktorit i kërkohet të analizojë e çertifikojë të gjithë elementet arkitektonikë e konstruktivë, inxhinierike të ketij projekti si: qëndrueshmëria, materialet, detajet, etj, dhe të propozojë një projekt zbatimi.

**<u>Standardet në paraqitjen e dokumentacionit teknik</u>**

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.

### 3.4. FAZIMI I PUNËS

### 3.4.2. Hartimin e projektit të zbatimit për objetin "Ndërtim Qendre Rekreative dhe Rikualifikim Urban i Parkut të Rezervuarit Thumanë, Krujë"

**3.4.2.1. Analiza e detyrës së projektimit**, rilevimi, mbledhja e dokumenteve - (formati A4, A3)

i) Shërbimet bazë

a) Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit/termave të referencës;

b) Dhënia e konsultave mbi nevojën dhe shkallët e shërbimit;

c) Formulimi i kërkesave për përzgjedhjen e specialistëve të tjerë të domosdoshëm në procesin e projektimit;

ç) Përmbledhja e rezultateve.

ii) Shërbimeve të veçanta:

a) Studimi I qëndrueshmërisë së digës

b) Analiza e vend ndodhjes

c) Planifikimi i punës

d) Verifikimi i pajtueshmërisë me mjedisin

**3.4.2.2. Projekt – idea paraprake** - (formati A3)

Për këtë fazë të projektit konsulenti duhet përgatisë një projekt ide ku do të përfshihen:

i) Shërbimi bazë

a) Përgatitja e një katalogu/liste të planeve, që detajon qëllimet e projektit (objektivat e programit);

b) Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera të ofruara nga specialistë e pjesëmarës në projekt;

c) Në projektimin e ambienteve të jashtme: mbledhja, vlerësimi dhe shpjegimi i të dhënave në lidhje me strukturën ekologjike dhe në marrëdhënie me elemente si psh. toka, uji, klima, ajri, flora dhe fauna, plus paraqitja e shfrytëzimit të hapësirës dhe përcaktimi i strategjisë me shpjegime informuese veçanërisht në lidhje me peizazhin, përmirësimin e zonës së banuar dhe ndërlidhjet, me bimësinë ekzistuese, mbjellje të reja, duke ndarë zonën e gjelbërimit, trafikun, ujin, zonat e lojrave dhe zonat sportive, gjithashtu qartësimi dhe pranimi i kufirit të projektit dhe harmonizimin me objektet rrethuese;

d) Parashikimi i kostove;

e) Mbledhja e përfundimeve e të gjitha aktiviteteve paraprake të projektit;

ii) Shërbimet e veçanta

a) Përgatitja e paraqitjeve të veçanta teknike, si p.sh. perspektiva, mostra, modele;

b) Hartimi i një plani kohor dhe organizimi.

c) Të përgatisë dhe të bëjë një prezantim të projektit përpara Përfituesit dhe Autoritetit Kontraktor.

### 3.4.2.3. **Projekt – idea perfundimtare** - (formati A3)

Për këtë fazë të projektit konsulenti duhet përgatisë një projekt ide perfundimtare ku do të përfshihen:

i) Shërbimi bazë

a) Përpunimi i konceptit të projektit (përpunim hap pas hapi i alternativave të përzgjedhura të ndërtimit me vizatime) duke marrë parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efiçencën financiare dhe energjitike dhe kërkesat mjedisore ose të zhvillimit të qëndrueshëm duke vënë në përdorim ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, dhe kompletimin e projektidesë përfundimtare.

b) Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera, të ofruara nga specialistë e pjesëmarrës në projekt.

c) Përshkrimi i projektit, me shpjegime për masat që do të ndërmerren për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe vlerave të tjera të kësaj natyre, duke përfshirë edhe masat për zëvendësimin, sipas legjislacionit në fuqi.

ç) Përmbledhja e të gjithë projektit në formën e vizatimit p.sh. projektidesë paraprake dhe/ose projektidesë përfundimtare (shkalla sipas natyrës dhe madhësisë së strukturës. Për sipërfaqet e hapura paraqitja të jetë në shkallë 1:500 deri në 1:100, veçanërisht me informacione për përmirësimin e mjedisit, masat që do të ndërmeren, masat për mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe për mbjelljen e diferencuar të gjelbërimit. Për ndërtesat në shkallë 1:50 deri 1:20, veçanërisht me detaje të mureve ndarëse, ngjyra, drita dhe materiale, në rast të veçantë edhe me plane të detajuara për grupet hapësinore.

d) Negociatat për mundësinë e marrjes së lejes së ndërtimit me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt.

dh) Parashikim i kostove sipas manualit te çmimeve, të miratuar me akte nën ligjore, që përcaktojnë kostot në zonat e banimit ose kërkesave cilësore të investitorit.

e) Kontrolli i kostove, duke krahasuar llogaritjen e kostos me koston paraprake.

ë) Përmbledhja e rezultateve të të gjithë dokumentacioneve të projektit.

### 3.4.2.4. Projekti i detajuar i zbatimit

Pas detyrës së miratuar nga Autoriteti Kontraktor dhe përfituesve, kontraktori do të vazhdojë me përgatitjen e projektit të detajuar të zbatimit, duke përfshirë si minimum por jo të kufizuar, si më poshtë:

#### 3.4.2.4.a. Projekti i zbatimit

i) Shërbimet bazë:

a) Përpunim dhe detajim i punës së bërë në fazat 3 dhe 4 (zhvillimi dhe paraqitja hap pas hapi e projektit të zgjidhur) duke marrë parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efiçencën fianciare dhe energjitike dhe kërkesat e mjedisit ose të konservimit duke përdorur edhe ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, nëpërmjet një projekti (vizatimi) të zbatueshëm.

b) Paraqitja e projektit në formë grafike me të gjitha detajet e nevojshme për zbatim p.sh. zbatimi i plotë përfundimtar, vizatime të detajuara të konstruksionit në një shkallë 1:50 deri 1:1, për strukturat në ambientet e jashtme në varësi të tipit të ndërtesës, në një shkallë 1:200 deri ne 1:50, veçanërisht për bimësinë, shoqëruar me relacionin përkatës.

c) Për ndërtesa: paraqitje e hollësishme e dhomave dhe apartamenteve në shkallë 1:25 deri 1:1 me përshkrimin, përcaktimin e materialeve.
ç) Përgatitja e bazës, për specialistët e tjerë të përfshirë në projekt dhe përfshirja e tyre në fazën e zbatimit.

**Studimi i qëndrueshmërisë së trupit të digës (formati A4/A3)**

- Studim hidrogjeologjik

  - Faza I

    1. Qartësimi i kërkesave të projektit;
    2. Përcaktimi i strukturës së tokës nga dokumentet ekzistuese, duke specifikuar dhe prezantuar strukturën e nëntokës, sipas testeve të kërkuara.

  - Faza II

    1. Analizimi dhe prezantimi i rezultateve të testeve, laboratorike dhe në terren për strukturën e nëntokës;
    2.Vlerësimi i gamës së lëkundjeve të tokës me përmbajtje uji;
    3. Vlerësimi i nëntokës, specifikimi i parametrave kryesorë në strukturën e tokës.

  - Faza III

    1. Paraqitja e rekomandimeve për qëndrueshmërinë e themeleve dhe presionet e lejuara në tokë, në rast të veçantë propozohet dhe dimensionimi i themelit;
    2. Deklaratë mbi çedimet e pritura nga realizimi i veprës për të realizuar shërbimet bazë të përfshira në projektin final;
    3. Udhëzimet për të gërmuar themelet dhe për të mbajtur edhe strukturën e thatë, edhe kontrollimin e ndikimit të projektit në strukturat ngjitur.

- Raport teknik i qëndrueshmërisë dhe kushteve të digës
- Plani i emergjencës për boshatisjen e rezervuarit në raste katostrofike dhe harta e përmbytjes (rrezikut)

**Projekti urbanistik (formati A2)**

**Projekti arkitektonik (formati A3) duhet të përfshijë këto fletë:**

- Analiza e gjendjes ekzistuese;
- Rilevimi topografik;
- Rilevimi gjeometrik dhe arkitektonik i gjëndjes ekzistuese të zonës;
- Planvendosje;
- Plan sistemimi - Detaje të sistemimit, detajimi i kuotave, lëvizja për PAK;
- Prerje teknike;

- Pamje teknike;
- Planimetria e kullimit të ujrave (detaje teknike);
- Planet e ndriçimit (detaje të mënyrës së vendosjes sipas llojit);
- Fotomontazh;
- Imazhe 3D;

**Projekti elektrik (formati A3) duhet të përfshijë këto fletë:**
- Planet e instalimeve elektrike;
- Ndriçimi i jashtëm;
- Planet e instalimeve të fuqisë;
- Llogaritjet dhe skemat e paneleve elektrike;
- Llogaritje të ndryshme për shtimin e fuqisë;
- Relacion i instalimeve elektrike.

**Projekti mekanik (formati A3) duhet të përfshijë këto fletë:**
- Instalimet e sistemit të kanalizimeve;
- Plani i kullimit, grumbullimit dhe shpërndarjes së ujrave të shiut;
- Relacion i instalimeve mekanike.

**Relacioni teknik (formati A4), i cili duhet të përmbajë:**
- Relacionin total (urbanistik, arkitektonik, konstruktiv, elektrik, mekanik);
- Përshkrimin e konceptit të projektimit, parametrat e projektimit, standardet e përdorura, metodologjia, llogaritjet e kryera;

**Preventivi i projektit të zbatimit (formati A4 – në excel)**
a) Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndarë sipas kategorive dhe zërave të punës;
b) Preventivin e zbatimit bazuar në Vendim i KM nr. 629, date 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike *të çmimeve të* punimeve *të ndërtimit* dhe *të* analizave teknike *të* tyre" ;
c) Për zërat që nuk përfshihen në Manual të bëhet analiza teknike e çmimit.

**Grafiku i punimeve (formati A4 – në excel)**

**Specifikime Teknike (formati A4)**
Kontraktori duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilin nga materialet që do të përdoren. Për secilin zë të përfshirë në preventiv duhet të bëhet analiza sipas kësaj skeme:
- Përshkrimi i detajuar i zërit të punimeve;
- Mënyra e vendosjes;
- Cilësia e kërkuar;
- Formatet e lejuara;
- Ngjyra e rekomanduar;
- Skica, vizatime ose foto (ku është e mundur).

**Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis**

A) Raportin teknik të projektit të propozuar, i cili përmban:

a) qëllimin e projektit të propozuar;

b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit;

c) kufijtë e sipërfaqes në hartë topografike, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ KRGJSH;

ç) fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;

d) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti;

dh) skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektit, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;

e) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;

ë) informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;

f) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;

g) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);

gj) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;

h) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;

i) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;

j) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;

B) Raportin paraprak të VNM-së, i cili përmban:

a) përshkrimin e mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;

b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;

c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;

ç) një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;

d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;

dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

## 4. REALIZIMI I PROJEKTIT

### 4.1. PROFILET E EKSPERTEVE, KUSHTET DHE DETYRIMET

Konsulenti do të propozojë ekspertët në disiplinat që ai gjykon të nevojshme në mënyrë që të mbulohet i gjithë qëllimi i punës i përshkruar sipas këtyre Termave të Referencës dhe të përgatiten kërkesat e paraqitura.
Konsulenti duhet të sigurohet që ekspertiza me kualifikimin e duhur, të identifikohet dhe t'i përshtatet kërkesave për secilën nga detyrat e listuara mësipër. Nisur nga dimensioni dhe kompleksiteti i punës për t'u realizuar, grupi i ekspertëve duhet të ketë karakter shumë-disiplinor dhe ku përfshihen profesionistë të cilët do të:

- Adresojnë çështjet më emergjente nga një pikëpamje shumë-disiplinore;
- Ofrojnë njohje të thellë të territorit shqiptar, sfidave dhe potencialeve të tij;
- Integrojnë apo adaptojnë eksperiencën e tyre në projekte të ngjashme në rajone të tjera.

Ekipi i Konsulentit do të punojë me stafin e bashkisë Krujë për projektin të zbatimit, ndaj ata duhet të ndërtojnë një marrëdhënie konstruktive, si dhe një transferim efektiv të njohurive dhe kompetencave.
Grupi i ekspertëve do të jetë i pëbërë nga stafi kryesor dhe ai mbështetës.
Me 'staf kryesor' do të kuptohet stafi teknik dhe menaxhues, i cili është thelbësor në këtë detyrë. Stafi kryesor duhet të identifikohet qartësisht si 'staf kryesor' dhe po ashtu stafi mbështetës duhet qartësisht të identifikohet si 'staf mbështetës' në propozimet për garën që shpallet nëpërmjet këtyre Termave.

**A. Stafi kryesor**

**1-Udhëheqësi i Grupit (PROJEKTUES ARKITEKT/ URBANIST)**

Duhet të ketë kompetencat e mëposhtme dhe të dorëzojë dokumentet dhe dëshmitë respektive:
Diploma Master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin arkitekt/urbanist/ planifikues territorial/industri druri/agromjedis dhe ekologji/hioritkulturë dhe arkitekturë peizazhi.
Licensë profesionale në projektim, kat.2.d (Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe)
Eksperienca të mëparshme në projekte të rikualifikimeve urbane/peizazheve/parqeve natyrore etj dhe disiplina të ngjashme me të;
CV, në të cilën të theksohet eksperienca në projekte të ngjashme.

**2-Koordinator Projekti (PROJEKTUES INXHINIER NDËRTIMI)**
Diploma Master ose diplomë e integruar të nivelit të dytë në profilin e Inxhinierisë së Ndërtimit.

Licensë profesionale në projektim, kat.6.a (Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore)
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Roli i Koordinatorit të Projektit mund të mbulohet edhe nga një prej anëtarëvë të propozuar të Stafit Kryesor. Vlerësimi i Koordinatorit të Projektit do të bëhet bazuar në aftësitë e tij menaxheriale si dhe në eksperiencat e tij e mëparshme në menaxhim.
Në rastin kur koordinatori i projektit nuk është inxhinier me përcaktimet e mësipërme por një specialist çfardo, projektuesi Inxhinier Ndërtimi do të kërkohet më vete, ekstra).

**3- Inxhinier ndërtimi/Inxhinier Strukturist (PROJEKTUES KONSTRUKTOR)**

Diploma master shkencor (jo master profesional) në profilin strukturist, diploma të integruara të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierisë së Ndërtimit (Përjashtuar profilin e Infrastrukturës së Transportit dhe profilit Hidroteknik).
Licensë profesionale në projektim, kat.3.b.2 (Projektim objekte me skelet metalik)
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

**4- Inxhinier Transporti/ rruga ura/ ndërtimi (PROJEKTUES RRUGËSH)**

Diploma Master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin e Inxhinierisë së Ndërtimit (përjashtuar profili Hidroteknik).
Licensë profesionale në projektim kat.6.a/ (Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore)
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

**5- Inxhinier gjeodet (PROJEKTUES GJEODET)**

Diploma master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet gjeodet/ Inxhinier Topograf/ Inxhinier Gjeomatik.
Licensë profesionale në projektim kat.8.a (Rilevime inxhinierike)
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

**6- Inxhinier elektrik (PROJEKTUES INSTALATOR)**

Diploma Master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin e Inxhinierisë Elektrike.
Licensë profesionale në projektim kat.4.i (Projektim i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçim të objekteve të mëdha sportive)
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

**7- Inxhinier hidroteknik (PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE)**

Diploma Master ose diplomë të integruar të niveltit të dytë në profilin Hidroteknik të Inxhinierisë së Ndërtimit/Profili Qytetare Industriale me diplomë para 1971.
Licensë profesionale në projektim kat.5.d (Projektim **vepra ujitje-kullimi**-impiante vaditëse-**diga të vogla** (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha)-damba-sifona-kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, prita, barazhe, porta, tombino);
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

**9-Inxhinier/ Ekspert Mjedisor**
Diploma Master ose diplomë të integruar të niveltit të dytë në profilin Inxhinieri Mjedisi të Inxhinierisë së Ndërtimit/ kimist teknolog diplomuar para vitit 1985). (Kjo liçensë jepet për Personat Juridik).
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

**10-Inxhinier/ Ekspert Gjeolog**
Diploma Master ose diplomë të integruar të niveltit të dytë në profilin Gjeologji Inxhinierike/ hidrologji/ Gjeoteknike).
Licensë profesionale në projektim kat.9.e (studime e projektime hidrogjeologjike)
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

| **Pozicioni** | **Përgjegjësitë e Caktuara për Stafin Kryesor** |
|---|---|
| 1- Udhëheqës Grupi | Drejton grupin e përgjithshëm të punës për përmbushjen e detyrës në ngarkim;<br>Ofron ekspertizë me njohuri mbi planifikimin dhe zhvillimin e infrastrukturës në kuadër të rekreacionit, sektorit të turizmit;<br>Udhëheq zhvillimin e rezultateve të dakortësuara dhe rishikon cilësinë e tyre brenda një kornize kohore të aprovuar;<br>Udhëheqësi i Grupit do të jetë përgjegjës për formulimin e vizionit dhe për udhëheqjen e planifikuesve dhe inxhinierëve në planifikimin e parashikimin e zhvillimit të sektorit;<br>**Udhëheqësi i Grupit do të angazhohet me kohë të pjesshme pranë njësisë.** |
| **2-** Koordinator Projekti | Siguron koordinimin dhe bashkëpunimin midis ekspertëve të ndryshëm, konsulentëve, specialistëve dhe stafit vendor;<br>Koordinon dhe asiston në përgatitjen dhe drejtimin e aktiviteteve të projektit për të siguruar vazhdimësinë e projektit;<br>Mbikëqyr punën e anëtarëve të grupeve dhe menaxhon përpilimin e raporteve;<br>Asiston këshillues të ndryshëm në detyrat e marra përsipër;<br>Asiston projektin në të gjitha çështjet organizative dhe menaxhuese;<br>Merr pjesë në formulimin e planeve të veprimit të projektit dhe ndihmon në sinkronizimin e palëve homologe në planifikimin e sistemit buxhetor;<br>Është bashkëpërgjegjës për përgatitjen, zbatimin dhe dokumentimin publik si dhe takime mes palëve të interesuara e aktiviteteve të projektit; |

| | |
|---|---|
| | Zhvillon dhe mban kontakte me palët e interesuara;<br>**Koordinatori i Projektit do të jetë i pranishëm me kohë të plotë.** |
| **3-**Inxhinier ndërtimi (konstruktor) | Eksperti do të ofrojë ekspertizë dhe njohuri mbi llogaritjet konstruktive për vendqëndrimet, pikat e vrojtimit etj, çështjet konstruktive;<br>Eksperti do të hartojë specifikime të përgjithshme teknike dhe do të vlerësojë kostot përkatëse që lidhen me konstruksionet.<br>**Ky anëtar i stafit kryesor do të jetë i pranishëm me kohë të pjesshme.** |
| **4-** Inxhinier Transporti | Eksperti do të ofrojë ekspertizë dhe njohuri mbi planifikimin e transportit, çështjet e trafikut dhe projektimit të rrugëve;<br>Eksperti do të hartojë specifikime të përgjithshme teknike dhe do të vlerësojë kostot përkatëse.<br>**Ky anëtar i stafit kryesor do të jetë i pranishëm me kohë të pjesshme.** |
| **5-** Inxhinier gjeodet | Eksperti do të ofrojë ekspertizë dhe njohuri mbi planifikimin e transportit, çështjet e azhornimeve topografike e rilevimeve, profilave gjatësor e tërthor;<br>Eksperti do të hartojë azhornimin topografik të terrenit horografinë, profilat gjatësor e tërthor në çdo piketë dhe do të përdorë instrumentin topografik GPS.<br>**Ky anëtar i stafit kryesor do të jetë i pranishëm me kohë të pjesshme së bashku me një ndihmës.** |
| **6-** Inxhinier elektrik | Eksperti do të ofrojë ekspertizë dhe njohuri mbi planifikimin e transportit, çështjet e trafikut dhe projektimit të rrugëve në fushën e ndriçimit rrugor apo azhornimit të linjave elektrike ekzistuese, me qëllim parandalimin e rreziqeve të munshme;<br>Eksperti do të hartojë specifikime të përgjithshme teknike (kapitullin e ndriçimit rrugor) dhe do të vlerësojë kostot përkatëse.<br>**Ky anëtar i stafit kryesor do të jetë i pranishëm me kohë të pjesshme.** |
| **7-** Inxhinier hidroteknik | Eksperti do të ofrojë ekspertizë dhe njohuri mbi planifikimin e transportit, projektimit të rrugëve në fushën e kanalizimeve të ujërave të shiut, llogaritjet hidraulike për efekt të dimensionimit dhe vleresimin e qendrueshmerise se dige.<br>Eksperti do të hartojë specifikime të përgjithshme teknike (kapitullin e kanalizimeve të ujërave të shiut) dhe do të vlerësojë kostot përkatëse.<br>**Ky anëtar i stafit kryesor do të jetë i pranishëm me kohë të pjesshme.** |
| **9-** Inxhinier/ Ekspert Mjedisor | Eksperti Mjedisor do të ofrojë njohuri të specializuara në të gjitha çështjet që shfaqin apo paraqesin impakt mjedisor;<br>Do të dorëzojë raporte mbi zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore;<br>Do të jetë përgjegjës për përgatitjen e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin;<br>Do të asistojë grupin në përpilimin e rregullave dhe planeve të veprimit për mbrojtjen e zonave të ndjeshme mjedisore si edhe të zbutjes së impaktit negativ në problematikat e evidentuara;<br>**Ky anëtar i stafit kryesor do të jetë i pranishëm me kohë të pjesshme.** |
| **9-** Inxhinier/ Ekspert | Eksperti Gjeolog do të ofrojë njohuri të specializuara në të gjitha çështjet që shfaqin apo paraqesin problemet gjeologjike. |

| | |
|---|---|
| Gjeolog | Do të dorëzojë raporte mbi studimet hidrogjeologjike.<br>Do të asistojë grupin në përpilimin e rregullave dhe planeve të veprimit për mbrojtjen nga rrëshqitjet e probleme të tjera gjeologjike.<br>Do të përpilojë studimin gjeologjik të rajonit në fjalë.<br>**Ky anëtar i stafit kryesor do të jetë i pranishëm me kohë të pjesshme.** |
| | |

**PLANIFIKIMI DHE DORËZIMET**

**4.2.1. Periudha e fillimit**
Data e parashikuar e fillimit për ofrimin e shërbimeve do të jetë në ____________2022.

**4.2.2. Periudha e përfundimit e parashikuar ose kohëzgjatja**
Kohëzgjatja e shërbimeve do të jetë 2 muaj nga data e fillimit.

**4.2.3. Planifikimi - përfshirë periudhën e njoftimit për vendosjen e stafit**

| Nr. | Faza | Rezultati | Aktivitete_Detyra | Afati |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| 1 | Plani i menaxhimit | 3.4.1.1. Hartimi i draftit fillestar të projektplanit të menaxhimit | | 2 muaj |
| | | 3.4.1.2. Procesi i konsultimit publik | | |
| | | 3.4.1.3. Hartimi i planit të menaxhimit | | |
| 2 | Hartimi i projektit të zbatimit për objektin: Ndërtim Qendre Rekreative dhe Rikualifikim Urban i Parkut të Liqenin e Thumanës | 3.4.2.1. Analiza e detyrës së projektimit, rilevimi, mbledhja e dokumenteve | i) Shërbimet bazë<br>a) Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit/termave të referencës;<br>b) Dhënia e konsultave mbi nevojën dhe shkallët e shërbimit;<br>c) Formulimi i kërkesave për përzgjedhjen e specialistëve të tjerë të domosdoshëm në procesin e projektimit;<br>ç) Përmbledhja e rezultateve. | |
| | | | ii) Shërbimeve të veçanta:<br>a) Studimi i gjendjes<br>b) Analiza e vend ndodhjes<br>c) Planifikimi i punës<br>ç) Hartimi i një programi hapësinor<br>d) Hartimi i një programi funksionimi<br>dh) Verifikimi i rëndësisë së mjedisit<br>e) Verifikimi i pajtueshmërisë me mjedisin | |
| | | 3.4.2.2. Projekt – idea paraprake | i) Shërbimi bazë<br>a) Analiza e e bazës materiale dhe e parimeve;<br>b) Dakordësimi mbi objektivat (kushtet përreth objektivit, konfliktet eventuale për arritjen e objektivit);<br>c) Përgatitja e një katalogu/liste të planeve, | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | që detajon qëllimet e projektit (objektivat e programit);<br>ç) Zhvillimi i një plani konceptual duke përfshirë edhe alternativa të tjera të mundshme që i përgjigjen kushteve dhe kërkesave të projektit me vizatime dhe skica, vlerësimi i tyre, zëvendësimi i vizatimeve eksperimentale me vizatime të lira, me shënime përkatëse kur është e mundshme;<br>d) Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera të ofruara nga specialistë e pjesëmarës në projekt;<br>dh) Qartësimi dhe shpjegimi i rolit të objektit në planin e qytetit, nën aspektin e ndërthurjes dhe ndërveprimit të aspekteve funksionale, në gjendjen fizike dhe teknike, në efikasitetin financiar dhe energjitik dhe në faktorët e mjedisit ose faktorët ekologjikë, proceset dhe kushtet, si dhe barrën imponuese ekosistemet përkatëse dhe ndjeshmërinë e tyre; 27<br>e) Negociatat paraprake me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt për testimin e mundësisë së marrjes së lejes së ndërtimit të objektit;<br>ë) Në projektimin e ambienteve të jashtme: mbledhja, vlerësimi dhe shpjegimi i të dhënave në lidhje me strukturën ekologjike dhe në marrëdhënie me elemente si psh. toka, uji, klima, ajri, flora dhe fauna, plus paraqitja e shfrytëzimit të hapësirës dhe përcaktimi i strategjisë me shpjegime informuese veçanërisht në lidhje me peizazhin, përmirësimin e zonës së banuar dhe ndërlidhjet, me bimësinë ekzistuese, mbjellje të reja, duke ndarë zonën e gjelbërimit, trafikun, ujin, zonat e lojrave dhe zonat sportive, gjithashtu qartësimi dhe pranimi i kufirit të projektit dhe harmonizimin me objektet rrethuese;<br>f) Parashikimi i kostove;<br>g) Mbledhja e përfundimeve e të gjitha aktiviteteve paraprake të projektit. | |
| | | | ii) Shërbimet e veçanta<br>a) Kërkimi për mundësi zgjidhjesh sipas kërkesave principialisht të kundërta;<br>b) Plotësim i dokumenteve të planifikimit paraprak mbi bazën e kërkesave të veçanta;<br>ç) Hartimi i një analize objekti- funksionimit, shpenzimeve dhe dobia;<br>e) Përgatitja e paraqitjeve të veçanta teknike, si p.sh. perspektiva, mostra, modele;<br>ë) Hartimi i një plani kohor dhe organizimi.<br>g) Të përgatisë dhe të bëjë një prezantim të projektit përpara Përfituesit dhe Autoritetit Kontraktor. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 3.4.2.3. Projekt – idea perfundimtare | i) Shërbimi bazë<br>a) Përpunimi i konceptit të projektit (përpunim hap pas hapi i alternativave të përzgjedhura të ndërtimit me vizatime) duke marrë parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efiçencën fianciare dhe energjitike dhe kërkesat mjedisore ose të zhvillimit të qëndrueshëm duke vënë në përdorim ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, dhe kompletimin e projektidesë përfundimtare.<br>b) Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera, të ofruara nga specialistë e pjesëmarrës në projekt.<br>c) Përshkrimi i projektit, me shpjegime për masat që do të ndërmerren për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe vlerave të tjera të kësaj natyre, duke përfshirë edhe masat për zëvendësimin, sipas legjislacionit në fuqi.<br>ç) Përmbledhja e të gjithë projektit në formën e vizatimit p.sh. projektidesë paraprake dhe/ose projektidesë përfundimtare (shkalla sipas natyrës dhe madhësisë së strukturës. Për sipërfaqet e hapura paraqitja të jetë në shkallë 1:500 deri në 1:100, veçanërisht me informacione për përmirësimin e mjedisit, masat që do të ndërmeren, masat për mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe për mbjelljen e diferencuar të gjelbërimit. Për ndërtesat në shkallë 1:50 deri 1:20, veçanërisht me detaje të mureve ndarëse, ngjyra, drita dhe materiale, në rast të veçantë edhe me plane të detajuara për grupet hapësinore.<br>d) Negociatat për mundësinë e marrjes së lejes së ndërtimit me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt.<br>dh) Parashikim i kostove sipas manualit te çmimeve, të miratuar me akte nën ligjore, që përcaktojnë kostot në zonat e banimit ose kërkesave cilësore të investitorit.<br>e) Kontrolli i kostove, duke krahasuar llogaritjen e kostos me koston paraprake.<br>ë) Përmbledhja e rezultateve të të gjithë dokumentacioneve të projektit. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 3.4.2.4. Projekti i detajuar i zbatimit | i) Shërbimet bazë:<br>a) Përpunim dhe detajim i punës së bërë në fazat 3 dhe 4 (zhvillimi dhe paraqitja hap pas hapi e projektit të zgjidhur) duke marrë parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efiçencën fianciare dhe energjitike) dhe kërkesat e mjedisit ose të konservimit duke përdorur edhe ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, nëpërmjet një projekti (vizatimi) të zbatueshëm.<br>b) Paraqitja e projektit në formë grafike me të gjitha detajet e nevojshme për zbatim p.sh. zbatimi i plotë përfundimtar, vizatime të detajuara të konstruksionit në një shkallë 1:50 deri 1:1, për strukturat në ambientet e jashtme në varësi të tipit të ndërtesës, në një shkallë 1:200 deri ne 1:50, veçanërisht për bimësinë, shoqëruar me relacionin përkatës.<br>c) Për ndërtesa: paraqitje e hollësishme e dhomave dhe apartamenteve në shkallë 1:25 deri 1:1 me përshkrimin, përcaktimin e materialeve.<br>ç) Përgatitja e bazës, për specialistët e tjerë të përfshirë në projekt dhe përfshirja e tyre në fazën e zbatimit.<br>Projekti urbanistik | |
| | | | Projekti arkitektonik | |
| | | | Projekti elektrik | |
| | | | Projekti mekanik | |
| | | | Relacioni teknik | |
| | | | Preventivi i projektit të zbatimit | |
| | | | Grafiku i punimeve | |
| | | | Specifikime Teknike | |
| | | 3.4.2.5. Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis | Raportin teknik të projektit të propozuar | |
| | | | Raportin paraprak të VNM-së | |
| | | 3.4.2.6. Raporti gjeologjik | 1. Qartësimi i kërkesave të projektit;<br>2. Përcaktimi i strukturës së tokës nga dokumentet ekzistuese, duke specifikuar dhe prezantuar strukturën e nëntokës, sipas testeve të kërkuara.<br>1. Analizimi dhe prezantimi i rezultateve të testeve, laboratorike dhe në terren për strukturën e nëntokës;<br>2.Vlerësimi i gamës së lëkundjeve të tokës me përmbajtje uji;<br>3. Vlerësimi i nëntokës, specifikimi i parametrave kryesorë në strukturën e tokës. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | 1. Paraqitja e rekomandimeve për qëndrueshmërinë e themeleve dhe presionet e lejuara në tokë, në rast të veçantë propozohet dhe dimensionimi i themelit;<br>2. Deklaratë mbi çedimet e pritura nga realizimi i veprës për të realizuar shërbimet bazë të përfshira në projektin final, siç paraqitet tek neni 39;<br>3. Udhëzimet për të gërmuar themelet dhe për të mbajtur edhe strukturën e thatë, edhe kontrollimin e ndikimit të projektit në strukturat ngjitur. | |

## 4.2. RAPORTIMI

### 4.2.1. Përmbajtja, gjuha, paraqitja/ afati i komenteve, numri i kopjeve të raportit

Janë të detajuara në tabelën e mëposhtme:

| Raportet | Gjuha | Data e dorëzimit | Numri i kopjeve | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Report | CD |
| Projekt idea | AL | | 3 | 2 |
| Projekti i zbatimit | AL | | 3 | 2 |

Të gjitha raportet duhet të dorëzohen në formë fizike dhe në formë elektronike.
Burimet e informacionit duhet të referohen dhe të përfshihen nënjë listë të plotë të të gjithë personelit.
Vizatimet dhe raportet duhet të jenë në 3 (tre) kopje origjinale të printuara dhe në 2 (dy) CD me të gjitha materialet në formatet përkatëse (acad, word, excel, etj.).

Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari.
Të gjitha dokumentat e printuara duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal.

## 4.3. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

### 4.4.1. Përcaktimi i treguesve

Autoriteti Kontraktor përgjegjës për menaxhimin e kësaj kontrate është bashkia Krujë.

### 4.4.2. Angazhimi gjatë zbatimit

Bashkia Krujë kërkon që projektuesi të angazhohet gjatë fazës së zbatimit sa herë të jetë nevoja për sqarime, korigjime apo detajime të projektit që mund dhe duhet të ishin parashikuar dhe bërë gjatë projektimit.

### 4.4.3. Lehtësirat për Konsulentin dhe Aksesi në Informacion

Konsulenti duhet të ketë zyrën bazë në Shqipëri, në mënyrë që të jetë i afërt me vendin e projektit. Konsulenti do të jetë përgjegjës për qiranë e zyrës dhe ekspertët në fjalë.

Konsulenti do të jetë përgjegjës për transportin ndërkombëtar dhe lokal, akomodimin dhe shpenzimet për stafin e projektit, së bashku me materialet e komunikimit, printimet, prodhimin e raporteve dhe përkthimin. Interpretimi verbal në takime do të jetë siguruar nga konsulenti.

Bashkia Krujë do të sigurojnë akses në të gjitha informacionet relevante ekzistuese, harta, studime, modele, dokumentet ligjore etj., që disponon, menjëherë dhe pa kosto.

#### 4.4.4. Takimet teknike dhe mes palëve të interesuara

Aktivitetet e mësipërme të listuara do të bëhen në konsultim me bashkinë Krujë përmes takimeve periodike. Projekti i zbatimit duhet të miratohet nga autoriteti(et) kompetent(e), në përputhje me Ligjet në fuqi.

Konsulenti, bashkia Krujë do të organizojnë forume bashkërendimi ndërinstitucionale, ku i fundit do të paraqesë produktin përfundimtar, dhe në rast se kërkohet nga palët e interesuara do të bëhet edhe organizimi i takimeve publike.

#### 4.4.5. Transferimi i njohurisë

Konsulenti do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me bashkinë Krujë, me qëllim që ato të marrin pjesë aktivisht dhe intensivisht gjatë gjithë procesit të hartimit të projektit, për të dhënë kontribut, por edhe për të rritur kapacitetet e personave që do të punojnë për zbatimin e planit.

Në përfundim, konsulenti do të përgatisë një program mbi ngritjen dhe trajnimin e kapaciteteve së bashku me termat e referencës për çdo asistencë teknike që mund të kërkohet.

#### 4.4.6. Konfidencialiteti

Dokumentet dhe të dhënat që do të vihen në dispozicion të kompanisë nga bashkia Krujë, apo institucione të tjera publike, duhet të konsiderohen konfidenciale dhe nuk duhet të transmetohet tek palët e treta.

## 5. REFERENCA |SHTOJCA

01. Parku "Rezervuari i Thumanës"_VKM Për Mjedisin.
02. Liqeni_Thumanë_RNM_pasaporta
03. Skeda biologjike_Parku Thumanë (PNB) "Rezervuari Thumanë"
04. Informacion për Parkun e"Rezervuari të Thumanës dhe zonës përreth tij"
05. Informacion mbi fshatin Thumanë

# TERMA REFERENCE

# SHËRBIM KONSULENCE

PËR HARTIMIN E

PROJEKTIT TË ZBATIMIT PËR OBJEKTIN:

**"SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGËS BORIZANË-SUPERSTRADA FUSHË KRUJË-MILOT, NJ.A. THUMANË, KRUJË"**

**LËNDA**


**1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM**

1.1. TË DHËNAT GJEOGRAFIKE TË ZONËS

1.2. KUFIJTË DHE ZONIMI I RRUGËS BORIZANË-SUPERSTRADË

1.3. INFORMACION MBI ZONËN NË STUDIM

b) Rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot

**2. QËLLIMI, OBJEKTIVAT DHE NDIKIMI I PRITSHËM**

2.1. QËLLIMI

2.2. OBJEKTIVAT

b) Plani i Menaxhimit

c) Projekti i Zbatimit

2.3. NDIKIMI I PRITSHËM

**3. PËRSHKRIM I PUNËS**

3.1. METODOLOGJIA

3.2. SHËRBIMET E KËRKUARA DHE DOKUMENTAT PËR DORËZIM

b) Plani i Menaxhimit

c) Projekti i Zbatimit

3.3. STANDARDET, KËRKESAT ARKITEKTONIKE E KONSTRUKTIVE TË OBJEKTIT

3.4. FAZIMI I PUNËS

3.4.1. Analiza e detyrës së projektimit, rilevimi;

3.4.2. Projekt – idea paraprake;

3.4.2. Projekt – idea perfundimtare;

3.4.4. Projekti i detajuar i zbatimit për ndërhyrjen;

3.4.5. Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis.

**4. REALIZIMI I PROJEKTIT**

4.1. PROFILET E EKSPERTËVE, KUSHTET DHE DETYRIMET

4.2. PLANIFIKIMI DHE DORËZIMET

4.2.1 Periudha e fillimit

4.2.2 Periudha e përfundimit e parashikuar ose kohëzgjatja

4.2.3 Planifikimi - përfshirë periudhën e njoftimit për vendosjen e stafit

4.3. RAPORTIMI

4.4. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

4.4.1. Përcaktimi i treguesve

4.4.2. Angazhimi gjatë implementimit

4.4.3. Lehtësirat për Konsulentin dhe Aksesi në Informacion

4.4.4. Takimet teknike dhe mes palëve të interesuara
4.4.5. Transferimi i njohurisë
4.4.6. Konfidencialiteti

## 5. REFERENCA |SHTOJCA

## 1. PËRSHEKRIM I PËRGJITHSHËM

### 1.1 TË DHËNAT GJEOGRAFIKE TË ZONËS

Thumana shtrihet në pjesën Veriore të rrethit Krujë dhe kufizohet;
- në Lindje – fshati Brret, territori i Njësisë Vendore Krujë – Krujë;
- në Jug - nga Njësia Administrative Fushë Krujë;
- në Veri - nga rrethi Kurbin (Njësia Administrative Mamurras);
- në Perëndim - nga kufiri administrativ i rrethit Durrës (Njësia Administrative Ishëm).

Rruga lidhëse Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot, ndodhet në fshatin Borizanë të Njësisë Administrative Thumanë, bashkia Krujë.
Ky aks rural ndodhet ndërmjet fshatit Borizanë dhe territorit të fshatit Derven, pjesë të Njësisë Administrative Thumanë. Ndodhet në një distancë të baras– larguar ndërmjet qendrave të banuara Fushë Krujë e Thumanë, duke shtuar kështu një tjetër aks rrugor lidhës në hartën e Shqipërisë. Kjo rrugë lidh qendrën e fshatit Borizanë me Superstradën Fushë Krujë Milot.

Thumana ka një sipërfaqe urbane rreth 5 km2 dhe sipërfaqe administrative 58 km2 , e cila përbën 1.48 % të sipërfaqës së përgjithshme të rrethit Krujë prej 339 km2, ku banojnë rreth 14300 banorë, të organizuar në dhjetë fshatra (Thumanë, Derven, Borizanë, Dukagjin i Ri, Gramëz, Miliskaj, Kodër Thumanë, Bushnesh, Derven Kodër, Sukth Vendas) dhe një qendër urbane (qyteza Thumanë). Nga këto 66.6% jetojnë në fshatrat përreth ndërsa 33.4% në qytezën Thumanë. Ndodhet në koordinatat gjeografike; 41°32'53" Veri dhe 19°40'43" Lindja, në Grade, Minuta, Sekonda.
Referuar studimeve të bëra nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Thumana dhe zona perëndimore përreth tij bëjnë pjesë në zonën Kodrinore e Fushore.

**Harta shoqëruese Gjeologo-Inxhinierike.**



## 1.2 KUFIJTË E AKSIT RRUGOR




Kufijtë e këtij aksi rural rrugor janë:

**Veri:** Lagje Malmereve, fshati Borizanë ;
**Lindje:** Fshati Borizanë, aksi nacional Fushë Krujë Thumanë (i vjetër);
**Jug:** Lagje Malmereve, fshati Borizanë/territori i fshatit Derven Kodër;
**Përëndim:** Superstrada Fushë Krujë-Milot;

Rruga rurale lidhëse Borizanë-Thumanë është një rrugë që lidh qendrën e banuar Borizanë me aksin nacional Fushë Krujë-Milot, rrugë e cila ka qenë e asfaltuar por si pasojë e amortizimit ndër vite dhe e tonazhit të madh ka degraduar, duke u bërë thuajse e pakueshme. Sipërfaqja e përdorimit të territorit aktual jepet në tabelën e mëposhtme:




ZONAT E PLANIT
TH-UB-052, TH-UB-058, TH-UB-059, TH-B-012

Tabela 1. Të dhëna mbi përdorimin e territorit për sistemim-asfaltimin e rrugës

| **Emërtimi** | **Sasia** | **Shënime** |
|---|---|---|
| Gjatësia e rrugës | 3320 ml | |
| Gjërësia totale ekzistuese | 8m | |
| Gjërësia e pjesës asfaltike ekzistuese | 5m | |
| Gjërësia e kanalit kulluese anësor | 1m | |
| Gjërësia e bankinave ekzistuese | 2x1m | |
| Gjërësia e kanalit kullues kk1 | 6m | |
| **SIPËRFAQJA TOTALE E RRUGËS** | **26560M2** | |

## 1.3 INFORMACION MBI ZONËN NË STUDIM




Foto Google, Rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot

c) **Segmenti 1, L=1085M**



Foto. Segmenti 1, Rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot (Fillimi i rrugës)

Ky segment rrugor fillon në kryqëzimin e rrugës me rrugën nacionale Fushë Krujë-Milot, fillon në një zonë me mjaft trafik dhe përfundon në skajin perendimor të varrezave të fshatit Borizanë.
Kalon në një zonë mjaft të populluar, me banesa në dy anët e rrugës(lagja e Malmereve), në një terren që fillon fushor, pastaj kalon kodrinor, me mjaft kthesa.
Gjithashtu në këtë segment ka edhe infrastrukturë shoqëruese si linjat e ujësjellësit, elektrikut, internetit, kanalizimeve etj.
Nënshtresat ekzistuese janë mjaft të dobëta dhe të dëmtuara, po ashtu edhe shtresat rrugore janë të dëmtuara.
Parametrat ekzistues të rrugës janë:
-Shtresë ekzistuese çakëlli natyral , t=15cm.
-Shtresë ekzistuese çakëll makinerie, t=15cm.
-Shtresë ekzistuese stabilizanti, t=10cm.
-Shtresë binderi ekzistues, t=4cm.
-Shtresë asfaltobetoni ekzistues, t=3cm.

-Bankina çakëlli ekzistues, t=10cm.

-Gjithashtu në këtë segment ka edhe vepra arti, ku më e veçanta është ura mbi përroin e Borizanës, me Hd=8m, e cila shpesh herë mbytet si pasojë e kuotës së ulët dhe e daljes së përroit nga shtrati.



Foto.  Segmenti 1, rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot (Ura mbi Përroin Borizanë)



Foto. Segmenti 1, rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot (Ura mbi Përroin Borizanë)



Foto. Segmenti 1, Rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot



Foto.  Segmenti 1, Rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot



Foto.  Segmenti 1, Rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot



Foto.  Segmenti 1, Rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot

d) **Segmenti 2**




Foto.  Segmenti 2, Rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot(lidhja me Superstradën)

Ky segment rrugor fillon në në skajin perendimor të varrezave të fshatit Borizanë, lagja e Malmerëve(aty ku përfundon segmenti 1), përshkon rrugën lidhëse për gjatë gjithë gjatësisë dhe përfundon në nyjen lidhëse të superstradës Fushë Krujë-Milot.
Kalon në një zonë më pak të populluar(pjesa fundore prej 1800ml nuk ka banesa fare), me pak banesa në dy anët e rrugës, në një terren që fillon kodrinor, pastaj kalon fushor, me pak kthesa, ku pjesa fundore prej 1600m është e drejtë.
Gjithashtu në këtë segment ka pak infrastrukturë shoqëruese si linjat e ujësjellësit, elektrikut, internetit, kanalizimeve etj.
Nënshtresat ekzistuese janë mjaft të dobëta dhe të dëmtuara, po ashtu edhe shtresat rrugore janë të dëmtuara.
Parametrat ekzistues të rrugës janë:
-Shtresë ekzistuese çakëlli natyral , t=15cm.
-Shtresë ekzistuese çakëll makinerie, t=15cm.
-Shtresë ekzistuese stabilizanti, t=10cm.
-Shtresë binderi ekzistues, t=4cm.
-Shtresë asfaltobetoni ekzistues, t=3cm.
-Bankina çakëlli ekzistues, t=10cm.

-Gjishashtu në këtë segment ka edhe vepra arti, ku më e veçanta është ura mbi kanalin kullues KK1të Borizanës, me Hd=8m, e cila është e dëmtuar nga dëmtime fizike të para disa viteve, mjaft e rrezikshme për tu shfrytëzuar aktualish, në prag shembje.



Foto. Segmenti 2, rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot (Ura mbi kanalin KK1



Foto.  Segmenti 2, rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot (Ura mbi kanalin KK1)



Foto.  Segmenti 2, Rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot



Foto.  Segmenti 2, Rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot



Foto.  Segmenti 2, Rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot



Foto. Segmenti 2, Rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot

## 2. QËLLIMI, OBJEKTIVAT DHE NDIKIMI I PRITSHËM

### 2.1. QËLLIMI

Ky dokument shërben në hartimin e planit të menaxhimit të trafikut dhe projektit të zbatimit për Sistemim-asfaltimin e "rrugës Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot".
Qëllimi kryesor i projektit është: bërja funksionale e këtij aksi rrugor me një numër të madh mjetesh në qarkullim si edhe:

- Rritjen e cilësisë së shërbimit nëpërmjet krijimit të shtresave, nënshtresave dhe veprave të reja të artit;
- Rritjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve dhe shkurtimin e kohës së qarkullimit;
- Eleminimin e ndotjes së krijuar për banorët përreth, duke ndërtuar një rrugë të re dhe bashkkohore;
- Rritjen e numrit të përfitueseve;
- Eleminimin e trafikut në akset alternative.

## 2.2. OBJEKTIVAT

Konsulenti do të ofrojë dhe udhëheqë punën për hartimin e planit të menaxhimit dhe projektit të zbatimit për Sistemim-asfaltimin e "rrugës Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot".

Ky propozim duhet:

- të jetë konsistent dhe i integruar me programin qeveritar të menaxhimit të zonës;
- të jetë i strukturuar dhe shkruar në një mënyrë që personeli i zonës të jetë në gjendje të marrë planin dhe të zbatojë me përpjekje minimale dhe kuptim maksimal;
- të jetë i detajuar dhe i strukturuar kur rekomandon të gjitha aktivitetet e mundshme eko-turistike të shoqëruara me një plan fizibiliteti që përfshin menaxhim dhe financim.

**a. Objetivat kryesorë të planit të menaxhimit**

- Mbrojtja e vlerave biologjike, kulturore, sociale si dhe peizazhit të zonës, shfrytëzimi rracional i aksit të ri;

Krijimi i një aksi të ri rrugor, me parametra bashkëkohor, me trotuare, ndriçim rrugor do ti shërbente më mirë banorëve të zonës e zonave përreth.

- Zhvillimi ekonomik dhe rritja e cilësisë në qarkullimin rrugor, eleminimin e risqeve e rrezikut, parandalimin e aksidenteve.

**b. Objetivat kryesorë të Projektit të zbatimit**

- Rikualifikimi dhe rikompozimi i këtij aksi rrugor, me të gjithë elementët e saj.
- Rikonstruksioni dhe rijetëzimi i strukturave të braktisura;
- Ndërhyrje specifike në infrastrukturën përgjatë aksit rrugor dhe tek segmentet rrugore ekzistuese në hyrje të fshatit Borizanë;
- Infrastrukturë ndihmëse, parkim dhe përforcime të skarpateve, ndërtim i veprave të reja të artit, rikonstruksion i atyre ekzistuese;
- Krijimi i shfryerjes së trafikut në dy akset kombëtare parelele;
- Krijimi i trotuareve dhe ndriçimit të ri rrugor;
- Ndërtimi i tubacionit të ri HDPE për kullimin e ujërave, së bashku me pusetat respektive;
- Ndërtimi i tombinove e kalesave për banesat përreth;
- Rivitalizimi i zonës përreth;
- Ndërtimi i strukturave ndihmëse;
- Krijimi i hapësirave të përshtatshme për parkim (vendndërrimet për mjetet e rënda, nqse është e domosdoshme;

## 2.3. NDIKIMI I PRITSHËM

Bashkia Krujë ka nisur punën për koordinimin e procesit për hartimin e projektit të zbatimit për Sistemim-asfaltimin e "rrugës Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot".
Nëpërmjet këtij projekti synohet të realizohet ruajtja në gjendjen natyrore të rrugës ekzistuese e peizazhit, sistemet ekologjike dhe karakteristikat natyrore të zonës. Pritet që projekti i zbatimit të shpien drejt zhvillimit të qëndrueshëm të territorit ku bënë pjesë zona në studim, të kontrollit të zhvillimit, kursimin e kohës, përmirësimin e cilësisë së jetesës, rritjes së mirëqënies së popullsisë vendase, punësimit, jetësës më të mirë dhe mbrojtjes së aseteve natyrore e mjedisit. Aksi rrugor ndodhet në një zonë mjaft të populluar dhe me shumë trafik, ku trafiku pas rikonstruksionit të kësaj rruge do të bjerë ndjeshëm në zonat përreth.

## 3. METODOLOGJIA E PUNËS, SHËRBIMET E KËRKUARA DHE DOKUMENTAT PËR DORËZIM

### 3.1. METODOLOGJIA

Konsulenti thirret, nëpërmjet këtij projekti, për të asistuar bashkinë Krujë, për hartimin e projekt-preventivit përkatës.
Konsulenti do të punojë ngushtësisht me stafin e bashkisë Krujë dhe Njësisë Administrative Thumanë përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit. Në mbështetje, është ngritur Grup pune për të koordinuar procesin për hartimin e planit të menaxhimit dhe projektit të zbatimit, i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin, vlerësimin e procesit, koordinimin dhe bashkërendimin e tij, sikurse edhe të produkteve që do të dalin prej tij dhe do të mbështesë të gjitha palët e përfshira në proces për t'u njohur dhe familjarizuar me detyrimet ligjore që rrjedhin nga detyra.
Periudha për draftimin e planit dhe ndjekjes së hartimit të projektit do të shtrihet në **60 ditë** dhe do të ndahet në faza për efekt të organizimit të procesit të punës, sipas përcaktimeve VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim".

### 3.2. SHËRBIMET E KËRKUARA DHE DOKUMENTAT PËR DORËZIM

**3.2.1.** Hartimin e projektit të zbatimit për Sistemim-asfaltimin e "rrugës Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot".

#### a) Projekti i zbatimit

- Analiza e detyrës së projektimit, rilevimi, mbledhja e dokumenteve;
- Projekt – idea paraprake;
- Projekt – idea perfundimtare;

- Projekti i detajuar i zbatimit për ndërhyrjen;
- Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis.

**b) Plani i menaxhimit te trafikut**

Plani i Menaxhimit duhet të përfshijë seksionet e mëposhtme ose të ndjekë një strukturë ekuivalente, bazuar në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë.

- Hyrje ku bëhet një përshkrim i përgjithshëm i Planit të Menaxhimit, qëllimi dhe kohëzgjatja;
- Realizimin e Planit të Menaxhimit të trafikut;
- Tabela, Skema dhe Harta.

### 3.3. STANDARDET, KËRKESAT ARKITEKTONIKE E KONSTRUKTIVE TË OBJEKTIT

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi për veprat rrugore. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.
Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.
Në hartimin e projektit të mbahen parasysh normat e miratuara për personat me aftësi të veçanta. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori. Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.
Gjatë gjithë fazave të projektimit, grupi i projektimit do të analizojë e të japë të dhëna të hollësishme për ecurinë.

**Kërkesa arkitektonike e konstruktive të objektit**

Kontraktorit i kërkohet të analizojë e çertifikojë të gjithë elementet arkitektonikë e konstruktivë, inxhinierike të ketij projekti si: qëndrueshmëria, materialet, detajet, etj, dhe të propozojë një projekt zbatimi.

**Standardet në paraqitjen e dokumentacionit teknik**

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.

### 3.4. FAZIMI I PUNËS

#### 3.4.1. Hartimin e projektit të zbatimit për Sistemim-asfaltimin e “rrugës Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot”.

**3.4.1.1. Analiza e detyrës së projektimit**, rilevimi, mbledhja e dokumenteve - (formati A4, A3)

i) Shërbimet bazë

a) Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit/termave të referencës;

b) Dhënia e konsultave mbi nevojën dhe shkallët e shërbimit;

c) Formulimi i kërkesave për përzgjedhjen e specialistëve të tjerë të domosdoshëm në procesin e projektimit;

ç) Përmbledhja e rezultateve.

ii) Shërbimeve të veçanta:

a) Studimi i gjendjes ekzistues te rruges

b) Analiza e vend ndodhjes

c) Planifikimi i punës

d) Verifikimi i pajtueshmërisë me mjedisin

**3.4.2.2. Projekt – idea paraprake** - (formati A3)

Për këtë fazë të projektit konsulenti duhet përgatisë një projekt ide ku do të përfshihen:

i) Shërbimi bazë

a) Analiza e bazës materiale dhe e parimeve;

b) Dakordësimi mbi objektivat (kushtet përreth objektivit, konfliktet eventuale për arritjen e objektivit);

c) Përgatitja e një katalogu/liste të planeve, që detajon qëllimet e projektit (objektivat e programit);

ç) Zhvillimi i një plani konceptual duke përfshirë edhe alternativa të tjera të mundshme që i përgjigjen kushteve dhe kërkesave të projektit me vizatime dhe skica, vlerësimi i tyre, zëvendësimi i vizatimeve eksperimentale me vizatime të lira, me shënime përkatëse kur është e mundshme;

d) Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera të ofruara nga specialistë e pjesëmarës në projekt;

dh) Qartësimi dhe shpjegimi i rolit të objektit në planin e qytetit, nën aspektin e ndërthurjes dhe ndërveprimit të aspekteve funksionale, në gjendjen fizike dhe teknike, në efikasitetin financiar dhe energjitik dhe në faktorët e mjedisit ose faktorët ekologjikë, proceset dhe kushtet, si dhe barrën imponuese ekosistemet përkatëse dhe ndjeshmërinë e tyre;

e) Negociatat paraprake me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt për testimin e mundësisë së marrjes së lejes së ndërtimit të objektit;

ë) Në projektimin e ambienteve të jashtme: mbledhja, vlerësimi dhe shpjegimi i të dhënave në lidhje me strukturën ekologjike dhe në marrëdhënie me elemente si psh. toka, uji, klima, ajri, flora dhe fauna, plus paraqitja e shfrytëzimit të hapësirës dhe përcaktimi i strategjisë me shpjegime informuese veçanërisht në lidhje me

peizazhin, përmirësimin e zonës së banuar dhe ndërlidhjet, me bimësinë ekzistuese, mbjellje të reja, duke ndarë zonën e gjelbërimit, trafikun, ujin, zonat e lojrave dhe zonat sportive, gjithashtu qartësimi dhe pranimi i kufirit të projektit dhe harmonizimin me objektet rrethuese;

f) Parashikimi i kostove;

g) Mbledhja e përfundimeve e të gjitha aktiviteteve paraprake të projektit;

ii) Shërbimet e veçanta

a) Kërkimi për mundësi zgjidhjesh sipas kërkesave principialisht të kundërta;

b) Plotësim i dokumenteve të planifikimit paraprak mbi bazën e kërkesave të veçanta;

ç) Hartimi i një analize objekti- funksionimit, shpenzimeve dhe dobia;

e) Përgatitja e paraqitjeve të veçanta teknike, si p.sh. perspektiva, mostra, modele;

ë) Hartimi i një plani kohor dhe organizimi.

g) Të përgatisë dhe të bëjë një prezantim të projektit përpara Përfituesit dhe Autoritetit Kontraktor.

**3.4.2.3. Projekt – idea perfundimtare** - (formati A3)

Për këtë fazë të projektit konsulenti duhet përgatisë një projekt ide perfundimtare ku do të përfshihen:

i) Shërbimi bazë

a) Përpunimi i konceptit të projektit (përpunim hap pas hapi i alternativave të përzgjedhura të ndërtimit me vizatime) duke marrë parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efiçencën fianciare dhe energjitike dhe kërkesat mjedisore ose të zhvillimit të qëndrueshëm duke vënë në përdorim ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, dhe kompletimin e projektidesë përfundimtare.

b) Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera, të ofruara nga specialistë e pjesëmarrës në projekt.

c) Përshkrimi i projektit, me shpjegime për masat që do të ndërmerren për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe vlerave të tjera të kësaj natyre, duke përfshirë edhe masat për zëvendësimin, sipas legjislacionit në fuqi.

ç) Përmbledhja e të gjithë projektit në formën e vizatimit p.sh. projektidesë paraprake dhe/ose projektidesë përfundimtare (shkalla sipas natyrës dhe madhësisë së strukturës. Për sipërfaqet e hapura paraqitja të jetë në shkallë 1:500 deri në 1:100, veçanërisht me informacione për përmirësimin e mjedisit, masat që do të ndërmeren, masat për mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe për mbjelljen e diferencuar të gjelbërimit. Për ndërtesat në shkallë 1:50 deri 1:20, veçanërisht me detaje të mureve ndarëse, ngjyra, drita dhe materiale, në rast të veçantë edhe me plane të detajuara për grupet hapësinore.

d) Negociatat për mundësinë e marrjes së lejes së ndërtimit me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt.
dh) Parashikim i kostove sipas manualit te çmimeve, të miratuar me akte nën ligjore, që përcaktojnë kostot në zonat e banimit ose kërkesave cilësore të investitorit.
e) Kontrolli i kostove, duke krahasuar llogaritjen e kostos me koston paraprake.
ë) Përmbledhja e rezultateve të të gjithë dokumentacioneve të projektit.

### 3.4.2.4. Projekti i detajuar i zbatimit

Pas detyrës së miratuar nga Autoriteti Kontraktor dhe përfituesve, kontraktori do të vazhdojë me përgatitjen e projektit të detajuar të zbatimit, duke përfshirë si minimum por jo të kufizuar, si më poshtë:

#### 3.4.2.4.a. Projekti i zbatimit

i) Shërbimet bazë:
a) Përpunim dhe detajim i punës së bërë në fazat 3 dhe 4 (zhvillimi dhe paraqitja hap pas hapi e projektit të zgjidhur) duke marrë parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efiçencën fianciare dhe energjitike (p.sh. efiçenca e energjisë, përdorimi i burimeve enegjitike të rinovueshme) dhe kërkesat e mjedisit ose të konservimit duke përdorur edhe ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, nëpërmjet një projekti (vizatimi) të zbatueshëm.
b) Paraqitja e projektit në formë grafike me të gjitha detajet e nevojshme për zbatim p.sh. zbatimi i plotë përfundimtar, vizatime të detajuara të konstruksionit në një shkallë 1:50 deri 1:1, për strukturat në ambientet e jashtme në varësi të tipit të ndërtesës, në një shkallë 1:200 deri ne 1:50, veçanërisht për bimësinë, shoqëruar me relacionin përkatës.
c) Për ndërtesa: paraqitje e hollësishme e dhomave dhe apartamenteve në shkallë 1:25 deri 1:1 me përshkrimin, përcaktimin e materialeve.
ç) Përgatitja e bazës, për specialistët e tjerë të përfshirë në projekt dhe përfshirja e tyre në fazën e zbatimit.

**Projekti urbanistik (formati A2)**

**Projekti arkitektonik (formati A3) duhet të përfshijë këto fletë:**

- Analiza e gjendjes ekzistuese;
- Rilevimi topografik;
- Planvendosje;
- Plan sistemimi - Detaje të sistemimit, detajimi i kuotave, lëvizja për PAK;

- Profilat gjatesor
- Profilat terthore, profilat tip
- Detaje teknike;
- Planimetria e kullimit të ujrave (detaje teknike);
- Planet e ndriçimit (detaje të mënyrës së vendosjes sipas llojit);
- Imazhe 3D;

**Projekti elektrik (formati A3) duhet të përfshijë këto fletë:**
- Planet e instalimeve elektrike;
- Ndriçimi i jashtëm;
- Planet e instalimeve të fuqisë;
- Llogaritjet dhe skemat e paneleve elektrike;
- Relacion i instalimeve elektrike.

**Projekti mekanik (formati A3) duhet të përfshijë këto fletë:**
- Instalimet e sistemit të kanalizimeve;
- Plani i kullimit, grumbullimit dhe shpërndarjes së ujrave të shiut;
- Relacion i instalimeve mekanike.

**Relacioni teknik (formati A4), i cili duhet të përmbajë:**
- Relacionin total (arkitektonik, konstruktiv, elektrik, mekanik);
- Përshkrimin e konceptit të projektimit, parametrat e projektimit, standardet e përdorura, metodologjia, llogaritjet e kryera;
- Konkluzionet, rekomandimet dhe pritshmëritë e projektuesit/grupit të projektimit.

**Preventivi i projektit të zbatimit (formati A4 – në excel)**
a) Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndarë sipas kategorive dhe zërave të punës;
b) Preventivin e zbatimit bazuar në Vendim i KM nr. 629, date 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike *të çmimeve të* punimeve *të ndërtimit* dhe *të* analizave teknike *të* tyre" ;
f) Për zërat që nuk përfshihen në Manual të bëhet analiza teknike e çmimit.

**Grafiku i punimeve (formati A4 – në excel)**

**Specifikime Teknike (formati A4)**

Kontraktori duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilin nga materialet që do të përdoren. Për secilin zë të përfshirë në preventiv duhet të bëhet analiza sipas kësaj skeme:

- Përshkrimi i detajuar i zërit të punimeve;
- Mënyra e vendosjes;
- Cilësia e kërkuar;
- Formatet e lejuara;
- Ngjyra e rekomanduar;
- Skica, vizatime ose foto (ku është e mundur).

### 3.4.2.5. Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis

A) Raportin teknik të projektit të propozuar, i cili përmban:

a) qëllimin e projektit të propozuar;

b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit;

c) kufijtë e sipërfaqes në hartë topografike, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ KRGJSH;

ç) fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;

d) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti;

dh) skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektit, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;

e) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;

ë) informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;

f) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;

g) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);

gj) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;

h) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
i) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;
j) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
k) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit;
l) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

B) Raportin paraprak të VNM-së, i cili përmban:
a) përshkrimin e mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;
b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;
c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
ç) një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;
d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;
dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;
e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

**3.4.2.6. Raporti gjeologjik.**

Faza I

1. Qartësimi i kërkesave të projektit;
2. Përcaktimi i strukturës së tokës nga dokumentet ekzistuese, duke specifikuar dhe prezantuar strukturën e nëntokës, sipas testeve të kërkuara.

Faza II

1. Analizimi dhe prezantimi i rezultateve të testeve, laboratorike dhe në terren për strukturën e nëntokës;
2. Vlerësimi i gamës së lëkundjeve të tokës me përmbajtje uji;

3. Vlerësimi i nëntokës, specifikimi i parametrave kryesorë në strukturën e tokës.
Faza III
1. Paraqitja e rekomandimeve për qëndrueshmërinë e themeleve dhe presionet e lejuara në tokë, në rast të veçantë propozohet dhe dimensionimi i themelit;
2. Deklaratë mbi çedimet e pritura nga realizimi i veprës për të realizuar shërbimet bazë të përfshira në projektin final;
3. Udhëzimet për të gërmuar themelet dhe për të mbajtur edhe strukturën e thatë, edhe kontrollimin e ndikimit të projektit në strukturat ngjitur.

## 4. REALIZIMI I PROJEKTIT

### 4.1. PROFILET E EKSPERTEVE, KUSHTET DHE DETYRIMET

Konsulenti do të propozojë ekspertët në disiplinat që ai gjykon të nevojshme në mënyrë që të mbulohet i gjithë qëllimi i punës i përshkruar sipas këtyre Termave të Referencës dhe të përgatiten kërkesat e paraqitura.
Konsulenti duhet të sigurohet që ekspertiza me kualifikimin e duhur, të identifikohet dhe t'i përshtatet kërkesave për secilën nga detyrat e listuara mësipër. Nisur nga dimensioni dhe kompleksiteti i punës për t'u realizuar, grupi i ekspertëve duhet të ketë karakter shumë-disiplinor dhe ku përfshihen profesionistë të cilët do të:

- Adresojnë çështjet më emergjente nga një pikëpamje shumë-disiplinore;
- Ofrojnë njohje të thellë të territorit shqiptar, sfidave dhe potencialeve të tij;
- Integrojnë apo adaptojnë eksperiencën e tyre në projekte të ngjashme në rajone të tjera.

Ekipi i Konsulentit do të punojë me stafin e bashkisë për hartimin e projektit të zbatimit, ndaj ata duhet të ndërtojnë një marrëdhënie konstruktive, si dhe një transferim efektiv të njohurive dhe kompetencave.
Ekipi i Konsulentit dhe Grupi i punës do të raportojë në mënyrë të vazhdueshme, pranë bashkisë, mbi ecurinë e procesit të hartimit të planit të menaxhimit dhe projektit të zbatimit.
Grupi i ekspertëve do të jetë i pëbërë nga stafi kryesor dhe ai mbështetës.
Me 'staf kryesor' do të kuptohet stafi teknik dhe menaxhues, i cili është thelbësor në këtë detyrë. Stafi kryesor duhet të identifikohet qartësisht si 'staf kryesor' dhe po ashtu stafi mbështetës duhet qartësisht të identifikohet si 'staf mbështetës' në propozimet për garën që shpallet nëpërmjet këtyre Termave.

**A. Stafi kryesor**

Ekspertët e stafit kryesor duhet të ushtrojnë detyrat si në vijim:

**1-Udhëheqësi i Grupit (PROJEKTUES RRUGËSH)**
Duhet të ketë kompetencat e mëposhtme dhe të dorëzojë dokumentet dhe dëshmitë respektive:
Diploma Master në inxhinieri ndërtimi/rruga ura/ transporti ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin e inxhinierisë së ndërtimit (përjashtuar profilin hidroteknikë).
Licensë profesionale në projektim kat.6.a (Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë Interurbane dytësore)
Eksperienca të mëparshme në projekte të transportit rrugor dhe disiplina të ngjashme me të;
CV, në të cilën të theksohet eksperienca në projekte të ngjashme.

**2-Koordinator Projekti**
Diploma Master apo diplomë e integruar e nivelit të dytë në një prej fushave të lidhura me rrugët, si: inxhinier rrugësh/ transporti/ ndërtimi/ gjeodet (përjashto degën hidroteknikë).
Licensë profesionale në projektim kat.6.a (Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë Interurbane dytësore)
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.
Roli i Koordinatorit të Projektit mund të mbulohet edhe nga një prej anëtarëvë të propozuar të Stafit Kryesor. Vlerësimi i Koordinatorit të Projektit do të bëhet bazuar në aftësitë e tij menaxheriale si dhe në eksperiencat e tij e mëparshme në menaxhim.

**3-Inxhinier Transporti/ rruga ura/ ndërtimi (PROJEKTUES RRUGA-URA)**

Diploma Master ose diplomë e integruar e nivelit të dytë në profilin e Inxhinierisë së ndërtimit (përjashtuar profilin gjeoteknik)), Inxhinier Hidroteknik.
Licensë profesionale në projektim kat.7.a (Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri 10m)/ certifikatë në projektime transporti
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

**4-Inxhinier gjeodet (PROJEKTUES GJEODET)**

Diploma Master ose diplomë të Integruar të nivelit të dytë në profilet: gjeodet/ Inxhinier Topograf/ Inxhinier Gjeomatik.
Licensë profesionale në projektim 8.a (rilevime inxhinierike)/ certifikatë në projektime gjeodezike
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

**5-Inxhinier elektrik (PROJEKTUES INSTALATOR)**

Diploma Master ose diplomë e nivelit të dytënë profilet e Inxhinierisë Elektrike.

Licensë profesionale në projektim kat.4.i (Projektim i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive)
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

**6-Inxhinier hidroteknik (PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE)**

Diploma Master ose diplomë e nivelit të dytë në profilin hidroteknik të Inxhinierisë së Ndërtimit/ Profili Ndërtime qytetare Industriale me diplomë para 1971.
Licensë profesionale në projektim kat.5.d (Projektim vepra ujitje-**kullimi**-impiante vaditëse-diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha)-damba-sifona-kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, prita, barazhe, porta, **tombino**)
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

**7-Inxhinier mekanik (PROJEKTUES SINJALISTIKE RRUGORE)**

Diploma Master ose diplomë e Integruar e nivelit të dytë në profilin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Infrastrukturën e Transportit/ në profilin e Inxhinierisë Mekanike në Infrastrukturën e Transportit ose PST/Trafiku i Sigurisë Rrugore.
Licensë profesionale në projektim kat.11.a (projektim sinjalistike jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.
**8-Inxhinier/ Ekspert Mjedisor**
Diploma Master ose diplomë të integruar të niveltit të dytë në profilin Inxhinieri Mjedisi të Inxhinierisë së Ndërtimit/ kimist teknolog diplomuar para vitit 1985). (Kjo liçensë jepet për Personat Juridik).
CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

| **Pozicioni** | **Përgjegjësitë e Caktuara për Stafin Kryesor** |
|---|---|
| **1-** Udhëheqës Grupi | Drejton grupin e përgjithshëm të punës për përmbushjen e detyrës në ngarkim;<br>Ofron ekspertizë me njohuri mbi planifikimin dhe zhvillimin e infrastrukturës në kuadër të sektorit tëqarkullimit rrugor;<br>Udhëheq zhvillimin e rezultateve të dakortësuara dhe rishikon cilësinë e tyre brenda një kornize kohore të aprovuar;<br>Udhëheqësi i Grupit do të jetë përgjegjës për formulimin e vizionit dhe për udhëheqjen e planifikuesve dhe inxhinierëve në planifikimin e parashikimin e zhvillimit të sektorit;<br>**Udhëheqësi i Grupit do të angazhohet me kohë të pjesshme pranë njësisë.** |
| **2-** | Siguron koordinimin dhe bashkëpunimin midis ekspertëve të ndryshëm, |

| | |
|---|---|
| Koordinator Projekti | konsulentëve, specialistëve dhe stafit vendor;<br>Koordinon dhe asiston në përgatitjen dhe drejtimin e aktiviteteve të projektit për të siguruar vazhdimësinë e projektit;<br>Mbikëqyr punën e anëtarëve të grupeve dhe menaxhon përpilimin e raporteve;<br>Asiston këshillues të ndryshëm në detyrat e marra përsipër;<br>Asiston projektin në të gjitha çështjet organizative dhe menaxhuese;<br>Merr pjesë në formulimin e planeve të veprimit të projektit dhe ndihmon në sinkronizimin e palëve homologe në planifikimin e sistemit buxhetor;<br>Është bashkëpërgjegjës për përgatitjen, zbatimin dhe dokumentimin publik si dhe takime mes palëve të interesuara e aktiviteteve të projektit;<br>Zhvillon dhe mban kontakte me palët e interesuara;<br>**Koordinatori i Projektit do të jetë i pranishëm me kohë të plotë.** |
| **3-**Inxhinier Transporti | Eksperti do të ofrojë ekspertizë dhe njohuri mbi planifikimin e transportit, çështjet e trafikut dhe projektimit të rrugëve;<br>Eksperti do të hartojë specifikime të përgjithshme teknike dhe do të vlerësojë kostot përkatëse, do të hartojë llogaritjet e tonazhit dhe shtresave rrugore, llogoaritjet konstruktive të urave dhe veprave të artit.<br>**Ky anëtar i stafit kryesor do të jetë i pranishëm me kohë të pjesshme.** |
| **4-**Inxhinier gjeodet | Eksperti do të ofrojë ekspertizë dhe njohuri mbi planifikimin e transportit, çështjet e azhornimeve topografike, profilave gjatësor e tërthor;<br>Eksperti do të hartojë azhornimin topografik të terrenit horografinë, profilat gjatësor e tërthor në çdo piketë dhe do të përdorë instrumentin topografik GBS.<br>**Ky anëtar i stafit kryesor do të jetë i pranishëm me kohë të pjesshme së bashku me një ndihmës.** |
| **5-**Inxhinier elektrik | Eksperti do të ofrojë ekspertizë dhe njohuri mbi planifikimin e transportit, çështjet e trafikut dhe projektimit të rrugëve në fushën e ndriçimit rrugor apo azhornimit të linjave elektrike ekzistuese, me qëllim parandalimin e rreziqeve të munshme;<br>Eksperti do të hartojë specifikime të përgjithshme teknike(kapitullin e ndriçimit rrugor) dhe do të vlerësojë kostot përkatëse.<br>**Ky anëtar i stafit kryesor do të jetë i pranishëm me kohë të pjesshme.** |
| **6-**Inxhinier hidroteknik | Eksperti do të ofrojë ekspertizë dhe njohuri mbi planifikimin e transportit, çështjet e trafikut dhe projektimit të rrugëve në fushën e kanalizimeve të ujërave të shiut, llogaritjet hidraulike për efekt të dimensionimit të urave e veprave të artit e mospërmbytjes së rrugëve;<br>Eksperti do të hartojë specifikime të përgjithshme teknike(kapitullin e kanalizimeve të ujërave të shiut) dhe do të vlerësojë kostot përkatëse.<br>**Ky anëtar i stafit kryesor do të jetë i pranishëm me kohë të pjesshme.** |
| **7-**Inxhinier | Eksperti do të ofrojë ekspertizë dhe njohuri mbi planifikimin e transportit, |

| | |
|---|---|
| mekanik | çështjet e trafikut dhe projektimit të rrugëve në fushën e sinjalistikës rrugore jo ndriçuese;<br>Eksperti do të hartojë specifikime të përgjithshme teknike(kapitullin e sinjalistikës rrugore jo ndriçuese) dhe do të vlerësojë kostot përkatëse.<br>**Ky anëtar i stafit kryesor do të jetë i pranishëm me kohë të pjesshme.** |
| **8-**Inxhinier/ Ekspert Mjedisor | Eksperti Mjedisor do të ofrojë njohuri të specializuara në të gjitha çështjet që shfaqin apo paraqesin impakt mjedisor;<br>Do të dorëzojë raporte mbi zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore;<br>Do të jetë përgjegjës për përgatitjen e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin;<br>Do të asistojë grupin në përpilimin e rregullave dhe planeve të veprimit për mbrojtjen e zonave të ndjeshme mjedisore si edhe të zbutjes së impaktit negativ në problematikat e evidentuara;<br>**Ky anëtar i stafit kryesor do të jetë i pranishëm me kohë të pjesshme.** |

## 4.2. PLANIFIKIMI DHE DORËZIMET

### 4.2.1. Periudha e fillimit

Data e parashikuar e fillimit për ofrimin e shërbimeve do të jetë në _____________2022.

### 4.2.2.Periudha e përfundimit e parashikuar ose kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shërbimeve do të jetë 60 ditë nga data e fillimit.

### 4.2.3. Planifikimi - përfshirë periudhën e njoftimit për vendosjen e stafit

| Nr. | Faza | Rezultati | Aktivitete_Detyra | Afati |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Plani i menaxhimit | 3.4.1.1. Hartimi i draftit fillestar të projektplanit të menaxhimit | | |
| | | 3.4.1.2. Procesi i konsultimit publik | | |
| | | 3.4.1.3. Hartimi i planit të menaxhimit | | |
| 2 | Hartimi i projektit të zbatimit përobjektin“Sistemim-asfaltim I rrugës Borizanë-Superstrada Fushë Krujë-Milot” | 3.4.2.1. Analiza e detyrës së projektimit, rilevimi, mbledhja e dokumenteve | i) Shërbimet bazë<br>a) Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit/termave të referencës;<br>b) Dhënia e konsultave mbi nevojën dhe shkallët e shërbimit;<br>c) Formulimi i kërkesave për përzgjedhjen e specialistëve të tjerë të domosdoshëm në procesin e projektimit;<br>ç) Përmbledhja e rezultateve. | 60 ditë |
| | | | ii) Shërbimeve të veçanta:<br>a) Studimi i gjendjes<br>b) Analiza e vend ndodhjes<br>c) Planifikimi i punës<br>ç) Hartimi i një programi hapësinor<br>d) Hartimi i një programi funksionimi<br>dh) Verifikimi i rëndësisë së mjedisit<br>e) Verifikimi i pajtueshmërisë me mjedisin | |
| | | 3.4.2.2. Projekt – idea paraprake | i) Shërbimi bazë<br>a) Analiza e e bazës materiale dhe e parimeve;<br>b) Dakordësimi mbi objektivat (kushtet përreth objektivit, konfliktet eventuale për arritjen e objektivit);<br>c) Përgatitja e një katalogu/liste të planeve, që detajon qëllimet e projektit (objektivat e programit);<br>ç) Zhvillimi i një plani konceptual duke përfshirë edhe alternativa të tjera të mundshme që i përgjigjen kushteve dhe kërkesave të projektit me vizatime dhe skica, vlerësimi i tyre, zëvendësimi i vizatimeve eksperimentale me vizatime të lira, me shënime përkatëse kur është e mundshme;<br>d) Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera të ofruara nga specialistë e pjesëmarës në projekt;<br>dh) Qartësimi dhe shpjegimi i rolit të objektit në planin e qytetit, nën aspektin e ndërthurjes dhe ndërveprimit të aspekteve funksionale, në gjendjen fizike dhe teknike, në efikasitetin financiar dhe energjitik dhe në faktorët e mjedisit ose faktorët ekologjikë, proceset dhe kushtet, si dhe barrën imponuese ekosistemet përkatëse dhe ndjeshmërinë e tyre; 27<br>e) Negociatat paraprake me autoritetet vendore | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt për testimin e mundësisë së marrjes së lejes së ndërtimit të objektit;<br>ë) Në projektimin e ambienteve të jashtme: mbledhja, vlerësimi dhe shpjegimi i të dhënave në lidhje me strukturën ekologjike dhe në marrëdhënie me elemente si psh. toka, uji, klima, ajri, flora dhe fauna, plus paraqitja e shfrytëzimit të hapësirës dhe përcaktimi i strategjisë me shpjegime informuese veçanërisht në lidhje me peizazhin, përmirësimin e zonës së banuar dhe ndërlidhjet, me bimësinë ekzistuese, mbjellje të reja, duke ndarë zonën e gjelbërimit, trafikun, ujin, zonat e lojrave dhe zonat sportive, gjithashtu qartësimi dhe pranimi i kufirit të projektit dhe harmonizimin me objektet rrethuese;<br>f) Parashikimi i kostove;<br>g) Mbledhja e përfundimeve e të gjitha aktiviteteve paraprake të projektit. | |
| | | | ii) Shërbimet e veçanta<br>a) Kërkimi për mundësi zgjidhjesh sipas kërkesave principialisht të kundërta;<br>b) Plotësim i dokumenteve të planifikimit paraprak mbi bazën e kërkesave të veçanta;<br>ç) Hartimi i një analize objekti- funksionimit, shpenzimeve dhe dobia;<br>e) Përgatitja e paraqitjeve të veçanta teknike, si p.sh. perspektiva, mostra, modele;<br>ë) Hartimi i një plani kohor dhe organizimi.<br>g) Të përgatisë dhe të bëjë një prezantim të projektit përpara Përfituesit dhe Autoritetit Kontraktor. | |
| | | 3.4.2.3. Projekt – idea perfundimtare | i) Shërbimi bazë<br>a) Përpunimi i konceptit të projektit (përpunim hap pas hapi i alternativave të përzgjedhura të ndërtimit me vizatime) duke marrë parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efiçencën fianciare dhe energjitike (p.sh. eficencën e energjisë, përdorimi i burimeve enegjitike të rinovueshme) dhe kërkesat mjedisore ose të zhvillimit të qëndrueshëm duke vënë në përdorim ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, dhe kompletimin e projektidesë përfundimtare.<br>b) Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera, të ofruara nga specialistë e pjesëmarrës në projekt.<br>c) Përshkrimi i projektit, me shpjegime për masat që do të ndërmerren për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe vlerave të tjera të kësaj natyre, duke përfshirë edhe masat për zëvendësimin, sipas legjislacionit në fuqi.<br>ç) Përmbledhja e të gjithë projektit në formën e vizatimit p.sh. projektidesë paraprake dhe/ose projektidesë përfundimtare (shkalla sipas natyrës dhe madhësisë së strukturës. Për sipërfaqet e hapura | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | paraqitja të jetë në shkallë 1:500 deri në 1:100, veçanërisht me informacione për përmirësimin e mjedisit, masat që do të ndërmeren, masat për mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe për mbjelljen e diferencuar të gjelbërimit. Për ndërtesat në shkallë 1:50 deri 1:20, veçanërisht me detaje të mureve ndarëse, ngjyra, drita dhe materiale, në rast të veçantë edhe me plane të detajuara për grupet hapësinore.<br>d) Negociatat për mundësinë e marrjes së lejes së ndërtimit me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt.<br>dh) Parashikim i kostove sipas manualit te çmimeve, të miratuar me akte nën ligjore, që përcaktojnë kostot në zonat e banimit ose kërkesave cilësore të investitorit.<br>e) Kontrolli i kostove, duke krahasuar llogaritjen e kostos me koston paraprake.<br>ë) Përmbledhja e rezultateve të të gjithë dokumentacioneve të projektit. | |
| | | 3.4.2.4. Projekti i detajuar i zbatimit | i) Shërbimet bazë:<br>a) Përpunim dhe detajim i punës së bërë në fazat 3 dhe 4 (zhvillimi dhe paraqitja hap pas hapi e projektit të zgjidhur) duke marrë parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efiçencën fianciare dhe energjitike (p.sh. efiçenca e energjisë, përdorimi i burimeve enegjitike të rinovueshme) dhe kërkesat e mjedisit ose të konservimit duke përdorur edhe ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, nëpërmjet një projekti (vizatimi) të zbatueshëm.<br>b) Paraqitja e projektit në formë grafike me të gjitha detajet e nevojshme për zbatim p.sh. zbatimi i plotë përfundimtar, vizatime të detajuara të konstruksionit në një shkallë 1:50 deri 1:1, për strukturat në ambientet e jashtme në varësi të tipit të ndërtesës, në një shkallë 1:200 deri ne 1:50, veçanërisht për bimësinë, shoqëruar me relacionin përkatës.<br>c) Për ndërtesa: paraqitje e hollësishme e dhomave dhe apartamenteve në shkallë 1:25 deri 1:1 me përshkrimin, përcaktimin e materialeve.<br>ç) Përgatitja e bazës, për specialistët e tjerë të përfshirë në projekt dhe përfshirja e tyre në fazën e zbatimit.<br>Projekti urbanistik | |
| | | | Projekti arkitektonik | |
| | | | Projekti elektrik | |
| | | | Projekti mekanik | |
| | | | Relacioni teknik | |
| | | | Preventivi i projektit të zbatimit | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Grafiku i punimeve | |
| | | | Specifikime Teknike | |
| | | 3.4.2.5. Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis | Raportin teknik të projektit të propozuar | |
| | | | Raportin paraprak të VNM-së | |
| | | 3.4.2.6. Raporti gjeologjik | 1. Qartësimi i kërkesave të projektit;<br>2. Përcaktimi i strukturës së tokës nga dokumentet ekzistuese, duke specifikuar dhe prezantuar strukturën e nëntokës, sipas testeve të kërkuara.<br>1. Analizimi dhe prezantimi i rezultateve të testeve, laboratorike dhe në terren për strukturën e nëntokës;<br>2.Vlerësimi i gamës së lëkundjeve të tokës me përmbajtje uji;<br>3. Vlerësimi i nëntokës, specifikimi i parametrave kryesorë në strukturën e tokës.<br>1. Paraqitja e rekomandimeve për qëndrueshmërinë e themeleve dhe presionet e lejuara në tokë, në rast të veçantë propozohet dhe dimensionimi i themelit;<br>2. Deklaratë mbi çedimet e pritura nga realizimi i veprës për të realizuar shërbimet bazë të përfshira në projektin final, siç paraqitet tek neni 39;<br>3. Udhëzimet për të gërmuar themelet dhe për të mbajtur edhe strukturën e thatë, edhe kontrollimin e ndikimit të projektit në strukturat ngjitur. | |

## 4.3. RAPORTIMI

### 4.3.1. Përmbajtja, gjuha, paraqitja/ afati i komenteve, numri i kopjeve të raportit

Janë të detajuara në tabelën e mëposhtme:

| **Raportet** | **Gjuha** | **Data e dorëzimit** | **Numri i kopjeve** | |
|---|---|---|---|---|
| | | | **Report** | **CD** |
| Projekt idea | AL | | 3 | 2 |
| Projekti i zbatimit | AL | | 3 | 2 |

Të gjitha raportet duhet të dorëzohen në formë fizike dhe në formë elektronike.
Burimet e informacionit duhet të referohen dhe të përfshihen në një listë të plotë të të gjithë personelit.
Vizatimet dhe raportet duhet të jenë në 3 (tre) kopje origjinale të printuara dhe në 2 (dy) CD me të gjitha materialet në formatet përkatëse (acad, word, excel, etj.).

Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari.
Të gjitha dokumentat e printuara duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal.

## 4.4. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

### 4.4.1. Përcaktimi i treguesve

Autoriteti Kontraktor përgjegjës për menaxhimin e kësaj kontrate ështëbashkia Krujë.
Një menaxher i projektit do të emërohet në emër të Autoritetit Kontraktor.
Bashkia Krujë është përfituese e këtij projekti. Ajoduhet të përfshihet në të gjitha konsultimet për këtë projekt.

### 4.4.2. Angazhimi gjatë implementimit

Bashkia Krujë kërkon që projektuesi të angazhohet gjatë fazës së implementimit sa herë të jetë nevoja për sqarime, korigjime apo detajime të projektit që mund dhe duhet të ishin parashikuar dhe bërë gjatë projektimit.

### 4.4.3. Lehtësirat për Konsulentin dhe Aksesi në Informacion

Konsulenti duhet të ketë zyrën bazë në Shqipëri, në mënyrë që të jetë i afërt me vendin e projektit. Konsulenti do të jetë përgjegjës për qiranë e zyrës dhe ekspertët në fjalë.

Konsulenti do të jetë përgjegjës për transportin ndërkombëtar dhe lokal, akomodimin dhe shpenzimet për stafin e projektit, së bashku me materialet e komunikimit, printimet, prodhimin e raporteve dhe përkthimin. Interpretimi verbal në takime do të jetë siguruar nga konsulenti.

Bashkia Krujë do të sigurojë akses në të gjitha informacionet relevante ekzistuese, harta, studime, modele, dokumentet ligjore etj., që disponon, menjëherë dhe pa kosto.

### 4.4.4. Takimet teknike dhe mes palëve të interesuara

Aktivitetet e mësipërme të listuara do të bëhen në konsultim me bashkinë Krujë përmes takimeve periodike. Plani i menaxhimit dhe projekti i zbatimit duhet të miratohen nga autoriteti(et) kompetent(e), në përputhje me ligjet në fuqi.

### 4.4.5. Transferimi i njohurisë

Konsulenti do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me bashkinë Krujë, me qëllim që ato të marrin pjesë aktivisht dhe intensivisht gjatë gjithë procesit të hartimit të planit dhe projektit, për të dhënë kontribut, por edhe për të rritur kapacitetet e personave që do të punojnë për zbatimin e planit.

Në përfundim, konsulenti do të përgatisë një program mbi ngritjen dhe trajnimin e kapaciteteve së bashku me termat e referencës për çdo asistencë teknike që mund të kërkohet.

#### 4.4.6. Konfidencialiteti

Dokumentet dhe të dhënat që do të vihen në dispozicion të kompanisë nga bashkia Krujë, apo institucione të tjera publike, duhet të konsiderohen konfidenciale dhe nuk duhet të transmetohet tek palët e treta.

## 6. REFERENCA |SHTOJCA

01. Informacion për rrugën Malmer (“Rruga Borizanë-Superstrada Fushë Krujë Milot”).
02. Informacion mbi Nj.A. Thumanë

**Shtojca 11**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

## FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit[3].

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**Shenim:**Kriteret e pergjithshme sipas shtojces nr.11.1 jane ekuivalente per te gjitha lotet e procedures perkatese te prokurimit.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

**LOTI I I:** (STUDIM PROJEKTIM PER OBJEKTIN,’’**NDËRTIM QENDRE REKREATIVE DHE RIKUALIFIKIM URBAN I PARKUT TË REZERVUARIT THUMANË, KRUJË”**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;(Ne vleren prej 2 % te fondit limit te lotit nr .1 )*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

[3] Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e sherbimeve të secilit anëtar, por fushat/ekpertizat e marra përsipër për tu realizuar.

**1-a)**Operatori ekonomik nuk duhet te kete detyrime te taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe ato te vitit 2022 te njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘’ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2022 per secilin operator)*

**Shenim-**Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit **e**shtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.12, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM **Nr. 285, datë 19.5.2021** , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2022 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘’ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2022 per secilin operator).*

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**a)-**Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12 ).

**b)**Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me liçencë të vlefshme profesionale të shoqërisë dhe të drejtuesve teknikë, për studim e projektim, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore (sipas modelit te miratuar nga MZHU/MTI/MIE) me kategoritë e mëposhtme:

**Kat 2.d /(Projektim arkitekturor peisazhi sistemim siperfaqe te gjelbera ,lulishte e parqe)**

**Kat 6.a/(Projektues Rruge e hekurudha ,rruge locale,rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore)**

**Kat 3.b.2 /(Projektues Konstrukturor –Objekte me skelet metalik)**

**Kat 8.a/(Projektues Gjeodet-Rivelime inxhinierike)**

**Kat 3.d/(Projektues Konstrukturor-Vleresimi I kapacitetit mbajtes dhe perforcimi i strukturave prej beton-arme, murature dhe metalike)**

**Kat 4.i/(Projektues Instalator/Projektim i ndricimit rrugor ,shesheve dekorativ,ndricimit te objekteve te medha sportive ,porteve aeroporteve etj)**

**Kat 5.d/(Projektues Vepra Hidraulike-Vepra ujitje kullimi impiante vaditese diga te vogla(ato qe nuk plotesojne kushtin e digave te medha), damba, sifona , kaskada, kaperdredhese .rrymeshpejtuese, prize,baraze, porta , tombina)**

**Kat 9.e/(Studim Gjeologjik Inxhinierik Hidrogjeologjik-Studime Projektime Hidreogjeologjike).**

**Shenim –**Licensa duhet te jete leshuar sipas rregullave te VKM nr 759 date 12.11.2014 ''Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" i ndryshuar me VKM nr 943 date 28.12.2016.

- *Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi*

**2.1.c)**Operatori ekonomik duhet të vërtetoje që ka të punësuar me kontratë 1(**nje**) **ekspert mjedisor** i cili duhet të jetë i regjistruar dhe i siguruar(te kete te punesuar me kontrate Ekspert te certifikuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave për vleresim të ndikimit në mjedis dhe auditim Mjedisor).

- **Shenim**-Per te provuar kriterin e mesipermpersa i perket ekpsertit mjedisor te paraqitet kontrata e punes e vlefshme, Diploma, Libreza e punes si dhe certifikata perkatese e vlefshme e leshuar nga insititucionet kompetente.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.a-**Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2020'2021'2022),ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te **kontrates/ lotit nr.1(*për secilin prej loteve/ shumatores së loteve për të cilat konkurron"*).**

**Shenim-**Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore .

**2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1-Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**
a)Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për sherbime te mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates **me një vlerë jo me te vogel se 20% e vlerës** së përllogaritur të kontratës/lotit **(*për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron*),** që prokurohet .

**Për të vërtetuar këtë Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin:**

- Kur furnizimi i sherbimeve te meparshme te ngjashme,është realizuar me institucione shtetërore,Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kontrates si dhe fatura tatimore të shitjes,të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara,të nënshkruara nga të dyja palët.

- Kur sherbimet e meparshme te ngjashme është realizuar me subjekte private,Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore te shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara,të nënshkruar nga të dyja palët.

***Shenim:****Në rastin e procedurave të prokurimit "Shërbim konsulence", si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

**3.4-.Personeli dhe fuqia punetore:**

Kandidati/ofertues duhet te vertetoje se disponon numrin e nevojshem te punonjesve per zbatimin e kontrates.dhe per kete provuar kete kusht duhet te kete **një punësim mesatar per periudhen , Dhjetor 2022 , deri ne Shkurt 2023 i te pakten 7 (shtate) personave duke përfshirë stafin e përhershëm te provuar si me poshte ;**

- Kjo pike (2.3.4 ), provohet duket paraqitur nga ana e OE , vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit **ose** nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates

  **ose**

- Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 025) sipas formatit elektronik ne perputhje me VKM nr 922 date 29.12.2014''**Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike''**

**Shenim-** Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.12 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar.

**3.5-.**Kandidati/ofertuesi duhet te paraqesi Certifikatat e Standartizimit si vijon te vlefshme :

- ***ISO* 9001:2015** (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) E vlefshme (Ne rast te dorezimit te ofertes nga bashkimi i operatoreve ekonomike , cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten ISO sipas zerave te sherbimeve qe do te marre persiper te realizoje sipas akt marreveshjes).
- **ISO 14001:2015** (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) E vlefshme. (Ne rast te dorezimit te ofertes nga bashkimi i operatoreve ekonomike , cdo anetar i grupit duhet te paraqese certifikaten ISO sipas zerave te sherbimeve qe do te marre persiper te realizoje sipas akt marreveshjes).

***Shënim:*** *Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma*

*ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të sherbimeve  që do të realizojë.*

***3.6-a)***Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertes së tyre ekonomike/financiare  duhet ti referohen VKM nr.354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”, si dhe Rekomandimit   të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017,  me Nr. 5585 Prot ”*Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354,datë 11.05.2016” “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe Rekomandimit te dates 27.06.2018 me nr 6559 prot te APP*.

***b)Shenim-***Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete  brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” .

**Shenim:** Ne zbatim te nenit 82.5 te Ligjit nr 162/2020 ‘’Per Prokurimin Publik’’ dhe  te pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : *“Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike[4]. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit te operatorit fitues para lidhjes se kontrates ,  ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimin. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.

[4] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**LOTI I II:** (STUDIM PROJEKTIM PER OBJEKTIN,“ **SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGËS BORIZANË-SUPERSTRADA FUSHË KRUJË MILOT, NJ.A.THUMANË, KRUJË”**

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**a.** ***Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12***

***b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;(Ne vleren prej 2 % te fondit limit te lotit nr .2 )***

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**1-a)**Operatori ekonomik nuk duhet te kete detyrime te taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe ato te vitit 2022 te njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘’ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2022 per secilin operator)*

**Shenim-**Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit **e**shtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.12, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM **Nr. 285, datë 19.5.2021** , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2022 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘’ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2022 per secilin operator).*

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**a)-**Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12 ).

**b)**Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me liçencë të vlefshme profesionale të shoqërisë dhe të drejtuesve teknikë, për studim e projektim, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore (sipas modelit te miratuar nga MZHU/MTI/MIE) me kategoritë e mëposhtme:

**Kat 6.a /((Projektues Rruge e hekurudha ,rruge locale,rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore)**

**Kat 7.a/ (Projektim ura dhe vepra arti-Ura dhe Vepra Arti deri ne 10 m)**

**Kat 8.a/(Projektues Gjeodet-Rivelime inxhinierike)**

**Kat 4.i/((Projektues Instalator/Projektim i ndricimit rrugor ,sesheve dekorativ,ndricimit te objekteve te medha sportive ,porteve aeroporteve etj)**

**Kat 5.d/(Projektues Vepra Hidraulike-Vepra ujitje kullimi impiante vaditese diga te vogla(ato qe nuk plotesojne kushtin e digave te medha), damba, sifona , kaskada, kaperdredhese .rrymeshpejtuese, prize,baraze, porta , tombina)**

**Kat 11.a/ (Projektues te Sinjalizimit Rrugor-Sinjalistike jondricuese ne rruge locale, rruge urbane dytesore, rruge interurbane dytesore, sheshe e parkimeve**

**Shenim –**Licensa duhet te jete leshuar sipas rregullave te VKM nr 759 date 12.11.2014 ‘’Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar me VKM nr 943 date 28.12.2016.

- *Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi*

**2.1.c)**Operatori ekonomik duhet të vërtetoje që ka të punësuar me kontratë **1(nje) ekspert mjedisor** i cili duhet të jetë i regjistruar dhe i siguruar(te kete te punesuar me kontrate Ekspert te certifikuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave për vleresim të ndikimit në mjedis dhe auditim Mjedisor).

- **Shenim**-Per te provuar kriterin e mesipermpersa i perket ekpsertit mjedisor te paraqitet kontrata e punes e vlefshme, Diploma, Libreza e punes si dhe certifikata perkatese e vlefshme e leshuar nga insititucionet kompetente.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.a-**Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2020’2021’2022 ) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te **kontrates/ lotit nr.2(*për secilin prej loteve/ shumatores së loteve për të cilat konkurron*”).**

**Shenim-**Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore .

**2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1-Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**
a)Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për sherbime te mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates **me një vlerë jo me te vogel se 20% e vlerës** së përllogaritur të kontratës/lotit (***për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron*)**, që prokurohet .

**Për të vërtetuar këtë Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin:**

- Per sherbimet e meparshme te ngjashme te cilat jane realizuar me institucione shtetërore,Operatori ekonomik do ta vërtetojë ekzekutimin e sherbimit/eve , duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kontrates si dhe fatura tatimore të shitjes,të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara,të nënshkruara nga të dyja palët.

- Kur sherbimet e meparshme te ngjashme jane realizuar me subjekte private,Operatori ekonomik do ta vërtetojë ekzekutimin e sherbimit/eve ,duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore te shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara,të nënshkruar nga të dyja palët.

***Shenim:**Në rastin e procedurave të prokurimit "Shërbim konsulence", si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

**<u>3.4-.Personeli dhe fuqia punetore:</u>**

Kandidati/ofertues duhet te vertetoje se disponon numrin e nevojshem te punonjesve per zbatimin e kontrates.dhe per kete provuar kete kusht duhet te kete **<u>një punësim mesatar per periudhen , Dhjetor 2022 , deri ne Shkurt 2023 i te pakten 7 (shtate) personave duke përfshirë stafin e përhershëm te provuar si me poshte ;</u>**

- Kjo pike (2.3.4 ), provohet duket paraqitur nga ana e OE , vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit **ose** nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates

  **ose**

